

UDHËZUES I EDUKIMIT LIGJOR PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE PËR MBROJTJEN E GRAVE KUNDËR DHUNËS SË BAZUAR NË GJINI DHE DHUNËS NË FAMILJE

Prishtinë, shkurt 2018



This programme
is funded by
the European Union



Përmbajtja

1. Hyrje	4
1.1. Audiencia e synuar.....	4
1.2 Përmbajtja	5
1.3 Synimi	5
1.4 Shkaqet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.....	6
1.5 Faktet dhe shifrat mbi dhunën ndaj grave	8
2. Standardet dhe normat ndërkombëtare	10
2.1 Të drejtat e grave si të drejtat e njeriut.....	10
2.2 Instrumentet gjithëpërfshirëse për të drejtat e njeriut	12
2.2.1 Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut.....	12
2.2.2 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore	12
2.2.3 Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Fundamentale të Njeriut	14
2.3 Instrumentet e specializuara për të drejtat e njeriut	15
2.3.1 Konventa për të Drejtat e Fëmijës.....	15
2.3.2 Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)....	15
a) Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Gruas (Komiteti CEDAW).....	20
2.3.3 Deklarata për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave	22
2.3.4 Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim	23
2.3.5 Rezoluta 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë e Këshillit të Sigurimit të OKB.....	24
2.3.6 Rezoluta e OKB-së për Eliminimin e Dhunës në Familje ndaj Gruas	24
2.3.7 Zbatimi i drejtpërdrejtë i instrumenteve ndërkombëtare.....	25
3. Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit).....	25
3.1.Historiku	25
3.2 Përmbledhje	26
3.3 Qëllimet dhe përkufizimet	28
3.4 Të drejtat themelore, barazia dhe mosdiskriminimi.....	30
3.5 Detyrimet e shtetit.....	31

3.6 Parandalimi	32
3.7 Mbrojtja dhe mbështetja	32
3.8 Mjete dhe masa ligjore	34
3.9 Emigrimi dhe azili.....	36
3.10 Mekanizmi i monitorimit të Konventës	37
4. Kuadri ligjor kombëtar.....	38
4.1 Ligji Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore	38
4.2 Ligji Nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi	40
4.3 Ligji Nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje	40
4.4 Akte nënligjore, procedurat, dhe programe të veprimit	43
4.5 Kodi Penal i Republikës së Kosovës.....	44
4.6 Strategjia Kombëtare e Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i saj i Veprimit 2016–2020	46
4.6.1 Objektivat strategjike dhe specifike	46
4.6.2 Institucionet dhe mekanizmat ekzistues në përgjigje të dhunës në familje.....	48
5. Rekomandime	50
5.1 Lista e Kontrollit	62
6. Shtojca: Lista e kontakteve	64

1. Hyrje

Dhuna ndaj grave është një prej shkeljeve më të rënda të të drejtave të njeriut dhe pengesë e madhe në realizimin e barazisë dhe në arritjen e prosperitetit dhe paqes në shoqëri. Sot dhuna ndaj grave gjithnjë e më shumë është e njohur jo vetëm si shkelje e të drejtave individuale, por edhe si kërcënim për demokracinë, pengesë për zhvillim shoqëror dhe rrezik për paqe të qëndrueshme. Për këtë arsye, dhuna ndaj grave dhe vajzave, dhe në veçanti dhuna brenda familjes, janë akte që tronditin jo vetëm rrethin e ngushtë, por edhe të gjithë shoqërinë, dhe si të tilla kërkojnë angazhimin e të gjithë shoqërisë për raportimin dhe parandalimin e tyre. Në këtë aspekt, shoqëria civile duhet të jetë një lidhje mes qytetarit si individ dhe shtetit. Organizatat e shoqërisë civile paraqesin akter të fuqishëm e fushëveprimeve kolektive rreth interesave, qëllimeve dhe vlerave të përbashkëta. Organizatat jo-qeveritare (OJQ) ndihmojnë në angazhimin mbarë shoqëror për të ndryshuar mendësitë dhe për të ndërgjegjësuar publikun mbi pabarazinë gjinore dhe stereotipat e dëmshëm dhe për të promovuar fuqizimin social dhe ekonomik të vajzave dhe grave. Për më tepër, shoqëria civile ka për detyrë të angazhohet në parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe të promovojë një kulturë drejtësie dhe mbështetje për viktimat.

1.1. Audiencia e synuar

Ky udhëzues i edukimit ligjor i drejtohet në radhë të parë shoqërisë civile në Kosovë, e cila ka dëshmuar gatishmëri për të sfiduar qëndrimet ekzistuese, strukturat e pushtetit dhe legjislacionin diskriminues dhe e cila vazhdimisht lufton për të arritur ndryshime. Ndikimi i OJQ-vë, sidomos atyre që merren me promovimin e të drejtave të grave dhe mbrojtjen e grave nga dhuna, është rritur dukshëm në shoqërinë kosovare. OJQ-të janë në të njëjtën kohë partnerë strategjik në zbatimin e programeve qeveritare dhe mekanizma monitorues për të siguruar që shteti ofron shërbime të përshtatshme, multi-sektoriale, me kohë dhe me cilësi të lartë. Gjithashtu, roli i OJQ-ve ka një rëndësi të veçantë në programe të edukimit dhe ndërgjegjësimit për të luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje. Prandaj, udhëzuesi synon të ndihmojë OJQ-të, si dhe profesionistë ligjorë dhe punëtorë të shërbimeve profesionale, për të zgjeruar të kuptuarit e zotimeve dhe përgjegjësi të tyre sipas instrumenteve ndërkombëtarë dhe kornizës ligjore vendore. Mbrojtja e viktimave dhe zbatimi i ligjit kërkojnë njohuri të mjaftueshme ligjore. Është e rëndësishme që OJQ-të, profesionistët ligjorë, mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe publiku i gjerë janë të njoftuar me dispozitat ligjore për parandalimin e dhunës së bazuar

në gjini dhe dhunës në familje, dhe me dispozita që kanë të bëjnë me promovimin e barazisë gjinore. Njohja më e madhe e çështjeve ligjore do të intensifikon përpjekjet për të parandaluar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje dhe do të rrisë gjasat për mobilizim dhe mbështetje në raste të veçanta.

1.2 Përmbajtja

Udhëzuesi i edukimit ligjor është hartuar veçanërisht duke bazuar në instrumente dhe standarde ndërkombëtarë të cilat garantojnë të drejtat e grave dhe ofrojnë bazë për mbrojtje ligjore kundër dhunës ndaj grave, dhunës seksuale dhe dhunës në familje. Po ashtu, është bërë edhe një rishikim i kuadrit ligjor kombëtar. Udhëzuesi është konceptuar si një burim informacionesh, i cili synon të shërbej njëkohësisht si mjet edukimi për barazinë gjinore dhe si material avokimi kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Udhëzuesi paraqet zotimet në përputhje me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në veçanti me Konventën e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (Konventa CEDAW) dhe Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (që njihet ndryshe si Konventa e Stambollit). Theks i veçantë është dhënë Konventës së Stambollit, e cila është traktat më i përparuar ndërkombëtar për të trajtuar çështjet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Konventa është instrument i parë në Evropë për të vendosur standarde ligjorisht detyruese në mënyrë specifike për të parandaluar dhunën me bazë gjinore, për të mbrojtur viktimat e dhunës dhe për të ndëshkuar kryerësit e krimit. Gjithashtu, kjo Konventë prezanton një numër karakteristikash të reja për të luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, tiparet novatorë e së cilës ende nuk janë të njohura mjaftueshëm për shoqërinë kosovare. Njëkohësisht, udhëzuesi shpjegon dispozitat relevante të kuadrit ligjor kosovar, dhe veprimet e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2016-2020, e cila është një strategji gjithëpërfshirëse për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje në Kosovë.

1.3 Synimi

Ky udhëzues i edukimit ligjor synon të ndihmojë ndërtimin e njohurive dhe aftësive më të gjera për instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të fokusuara në barazinë gjinore dhe luftimin e dhunës ndaj grave, dhe për zbatimin e tyre në Kosovë. Po ashtu, udhëzuesi synon

afrimin e kuadrit ligjor kosovar nëpërmjet zbërthimit të dispozitave që trajtojnë çështjet e barazisë gjinore, dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Në të njëjtën kohë, udhëzuesi i edukimit ligjor ka për qëllim të ofron informata rreth masave konkrete për të luftuar dhunën ndaj grave, siç parashikohet me Strategjinë Kombëtare. Udhëzuesi i edukimit ligjor shpjegon se si të respektohen parimet e barazisë gjinore dhe ofron informata si të përdoren dispozitat ligjore në përpjekjet për t'i dhënë fund dhunës kundër grave dhe vajzave. Udhëzuesi tenton të shërbej si mjet i dobishëm për të mbështetur përpjekjet për të siguruar drejtësi, mbështetje, mbrojtje dhe mjete juridike për viktimat dhe për t'i mbajtur përgjegjës kryesisht e dhunës.

Udhëzuesi synon të ndihmojë krijimin e tolerancës zero ndaj dhunës dhe njëkohësisht promovon mosdiskriminimin dhe barazinë gjinore si vlera publike që ofrojnë përfitime sociale, politike dhe ekonomike për individët dhe për shoqërinë në tërësi. Prandaj, udhëzuesi i edukimit ligjor ka për qëllim të shërbejë si një mjet avokimi për ngritjen e kapaciteteve dhe për rritjen e ndërgjegjësimit. Në të njëjtën kohë, udhëzuesi shërben si instrument për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe për mbrojtje cilësore juridike e viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

1.4 Shkaqet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje

“Dhuna ndaj grave është në thelb çështje e pushtetit. Ajo do të përfundojë vetëm kur barazia gjinore dhe fuqizimi i plotë i grave do të behën realitet.” (Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, António Guterres)¹

Sot gjerësisht pranohet që shkaqet e dhunës ndaj grave, dhunës seksuale dhe dhunës në familje rrjedhin nga nocionet e rrënjosura për statusin jo të barabartë të grave dhe mbështetjen mbi qëndrimet e shoqërisë ndaj diskriminimit gjinor. Pabarazia gjinore dhe diskriminimi konsiderohen si shkaqe kryesore të dhunës ndaj grave, që ekzistojnë në shkallë të ndryshme në të gjitha komunitete në mbarë botën. Pozita e pabarabartë i ekspozon gratë dhe vajzat ndaj rreziqeve të dhunës, duke përfshirë dhunën e bazuar në gjini, dhunën seksuale dhe familjare.

Dhuna kundër grave konsiderohet si “manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe grave, që kanë çuar në dominim dhe diskriminim të grave nga

¹ Vërejtjet e Sekretarit të Përgjithshëm për ditën ndërkombëtare për eliminimin e dhunës ndaj grave, 22 nëntor 2017. <https://www.un.org/sg/en/content/sg/statement/2017-11-22/secretary-generals-remarks-international-day-elimination-violence>.

burrat dhe kanë penguar përparimin e plotë të grave.”² Edhe sot, marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit, mungesa e fuqisë dhe kontrollit, të ndikuara nga faktorët historikë dhe strukturorë, shkaktojnë trajtim jo të barabartë të grave. Dhuna kundër grave “është një prej mekanizmave thelbësorë socialë me të cilin gratë janë të detyruara të vendosen në një pozicion varësie në krahasim me burrat.”³

Dhuna ndaj grave dhe vajzave është ndërlidhur gjithashtu me norma shoqërore që definojnë rolin e burrave dhe grave në shoqëri dhe me sjelljet që tolerojnë abuzimin. Rolet tradicionale gjinore shpesh u imponohen grave për të luajtur role sekondare në shoqëri, duke i vënë ato në një disavantazh në lidhje me homologët e tyre meshkuj. Pabarazitë midis burrave dhe grave shfaqen në të gjithë sferat e jetës publike dhe private dhe ndikojnë në realizimin e të drejtave të tyre sociale, ekonomike, kulturore dhe politike. Këto pabarazi rrisin rreziqet e abuzimit të grave dhe të vajzave dhe mundësojnë zhvillimin e marrëdhënieve të dhunshme dhe shfrytëzimit të grave, shpesh here për shkak të varësisë së tyre ekonomike dhe për shkak të mundësive të kufizuara. Pabarazia ndikon në kufizimin e lirive, zvogëlon mundësitë edhe ndikon në lirinë e zgjedhjes së grave. Po ashtu, konsiderohet që dhuna ndaj grave dhe vajzave nuk është vetëm një pasojë e pabarazisë gjinore, por edhe përforcon statusin e ulët të grave në shoqëri, dhe ndikon në pabarazitë e shumta midis grave dhe burrave. Si e tillë, dhuna ndaj grave, “pengon zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të komuniteteve dhe shteteve.”⁴

Ka një sërë faktorësh që, të vetëm apo të kombinuar me të tjerë, shoqërohen me një rritje të rrezikut për abuzim. Disa karakteristika të caktuara të grave, siç janë orientimi seksual, statusi i aftësisë së kufizuar, ose përkatësia etnike dhe disa faktorë kontekstual, siç janë krizat humanitare, duke përfshirë situatat e konfliktit dhe luftës, rrisin vulnerabilitetin e grave ndaj dhunës. Grupet e cënueshme sociale kanë nevojë për mbrojtje dhe mbështetje të veçantë. Në situata konflikti, dhuna seksuale përdoret si mjet i luftës, dhe si taktikë e poshtërimit dhe frikësimit të një komuniteti të veçantë etnik. Në situata të tilla, dhuna përjetohet nga gratë e të gjitha moshave.

Elementi kyç në parandalimin e dhunës kundër grave është realizimi i barazisë *de jure* dhe *de facto* midis burrave dhe grave. Barazia gjinore nënkupton që gratë dhe burrat (duke përfshirë

² Konventa e Stambollit, preambula.

³ Konventa e Stambollit, preambula.

⁴ Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Rezoluta 61/143, e miratuar me 19 dhjetor 2006.

vajzat dhe djemtë) kanë të njëjtat drejta dhe të njëjtat mundësi në të gjitha fushat e jetës, dhe bazohet në premisën që gratë dhe burrat duhet të trajtohen në mënyrë të njëjte. Kjo do të thotë që interesat, nevojat dhe prioritetet e të dy gjinive merren në të njëjtën konsideratë dhe shqyrtohen në mënyrë të njëjtë. Barazia gjinore gjithashtu kërkon masa pozitive për të përmirësuar pozitën e grave, e cila zakonisht është më e dobët në shoqëri, në mënyrë që të mundësohet arritja e barazisë përmes fuqizimit të grave. Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave është një nga Objektivat e Zhvillimi të Qëndrueshëm, të miratuara në shtator 2017, nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së.⁵ Ky objektivi përcakton eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe vajzave, si në sferën publike ashtu edhe në sferën private, sepse luftimi i dhunës ndaj grave nuk mund të ndahet nga fuqizimi i grave dhe si i tillë është prioritet global dhe parakusht i prosperitetit.

1.5 Faktet dhe shifrat mbi dhunën ndaj grave

Dhuna ndaj grave dhe vajzave është një shqetësim global. Shpesh theksohet që dhuna ndaj grave nuk njihet kufi: dhuna mbi përkatësinë gjinore është një realitet si në vendet në zhvillim ashtu edhe në vendet e zhvilluara, duke prekur gratë e të gjitha shtresave socio-ekonomike. Për prevalencën e dhunës flasin shifrat. Vlerësohet se 35 për qind e grave në mbarë botën në jetën e tyre kanë përjetuar dhunë fizike, dhe/apo dhunë seksuale nga partneri intim apo nga personi tjetër, ndërsa 38 për qind të vrasjeve të grave janë kryer nga partnerët intimë. Në disa vende situata është alarmante, sepse disa studime kombëtare tregojnë se numri i grave që kanë përjetuar gjatë jetës së tyre dhunë fizike dhe/ose seksuale nga një partner intim shkon deri në 70 për qind.⁶ Statistikat tregojnë që në shtete të Unionin Evropian, një nga tre gra (33%) kanë qenë viktimë të dhunës fizike dhe/ose seksuale, ndërsa 22% kanë përjetuar sjellje abuzive nga

⁵ Në shtator të vitit 2017, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, si një platformë që synon transformimin e gjithë njerëzimit dhe planetit tonë në një rrugë të qëndrueshme zhvillimi brenda vitit 2030. Agjenda definon 17 Objektiva për Zhvillim të Qëndrueshëm, të fokusuara në 17 grupe të fushave më të rëndësishme për njerëzimin. Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave është objektivi numër 5.

⁶ Organizata Botërore e Shëndetësisë, "Vlerësimet globale dhe rajonale të dhunës kundër grave: prevalenca dhe efektet shëndetësore të dhunës nga partneri intim dhe dhuna seksuale nga jo-partneri", 2014. Shiko në: UN Women, Facts and figures: Ending violence against women, <http://www.unwomen.org/en/what-we-do/ending-violence-against-women/facts-and-figures>. Informata me te hollësishme gjen ne: <http://evaw-global-database.unwomen.org/en>

partneri intim, megjithëse vlerësohet që vetëm rreth 30% të viktimave të dhunës raportojnë incidente më serioze.⁷

Dhuna ndaj grave ekziston në shoqërinë kosovare, pavarësisht ndryshimeve pozitive dhe përparimit të arritur në emancipimin e grave. Raporti i progresit i Komisionit Evropian thekson që dhuna e bazuar në gjini, duke përfshirë dhunën në familje, në mënyrë të konsiderueshme pengon gëzimin e plotë e të drejtave të grave në Kosovë.⁸ Dhuna në familje vazhdon të jetë forma më përhapur e dhunës që prek kryesisht gratë dhe fëmijët. Sipas të dhënave të policisë, në vitin 2016, gratë përbënin 80% të 1.247 rasteve të dhunës në familje të denoncuar në polici. Vlerësohet se numri i viktimave është shumë më i madh, sepse sipas vlerësimeve të autoriteteve, nuk bëhet kallëzim për shumicën e rasteve.

Sipas hulumtimit nga Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës,⁹ 62% e kosovarëve kanë përjetuar një ose më shumë forma të dhunës në familje në jetën e tyre (68% gra dhe 56% burra). Në vitin 2014, 41% e grave dhe 20% e burrave janë shprehur se kanë përjetuar një formë të dhunës në familje, përfshirë dhunën fizike, psikologjike dhe/ose ekonomike, ndërsa 7% e kosovarëve kanë thënë se partnerët e tyre u kanë bërë presion që të kenë marrëdhënie seksuale pa pëlqimin e tyre. Hulumtimi gjithashtu zbulon që mes vitit 2005 dhe 2015, të paktën 22 persona u vranë nga persona me të cilët kishin lidhje familjare. Sipas statistikave të mbledhura në hulumtim, gratë kanë më shumë të ngjarë se sa burrat të përjetojnë dhunë në familje. Hulumtimi evidenton grupet më të rrezikuara ndaj dhunës në familje të cilat janë gratë, fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, si edhe personat të komunitetit LGBT. Inkurajon fakti që hulumtimi regjistron një rritje të dukshme të vetëdijes për ekzistimin e masave ligjore për të luftuar dhunën në familje. 75.3% e popullsisë në Kosovë është e vetëdijshme se ekziston Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, ndërsa 75.9% deklaruan se do të përdornin ligjin në rast të ushtrimit të dhunës.

⁷ Për informata më të hollësishme shiko sondazhin e gjerë nga Agjencioni i Unionit Evropian për të Drejtat Themelore, 2015, në <http://fra.europa.eu/en/publication/2014/violence-against-women-eu-wide-survey-main-results-report>

⁸ Komisioni Evropian (2016). “Raporti i progresit për Kosovë” fq. 22, në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf

⁹ Hulumtimi i Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës “Mjaft më me arsytetime: Analizë e qëndrimeve, incidencës dhe reagimeve institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovë” në <http://www.womensnetwork.org/documents/20151124105025644.pdf>

2. Standardet dhe normat ndërkombëtare

Rëndësia për të kushtuar vëmendje çështjes së dhunës ndaj grave është rezultat i aktiviteteve të organizatave dhe lëvizjeve të grave në mbarë botën. Në të njëjtën kohë derisa gratë kërkonin të fitonin barazi dhe njohje të të drejtave të tyre në shumë fusha, ato po ashtu vurën në dukje faktin se dhuna ndaj grave nuk është vetëm pasojë e akteve individuale të sjelljes së keqe, por është thellësisht e rrënjësuar në marrëdhëniet strukturore të pabarazisë mes grave dhe burrave. Lëvizjet e grave, si faktori kyç për të arritur promovimin e të drejtave të grave, kanë qenë agjikator të zëshëm për të tërhequr vëmendjen në arenën ndërkombëtare ndaj nevojës së parandalimit dhe luftimit të dhunës ndaj grave. Avokimi për të drejta të barabarta të grave është ndërlidhur me zhvillime dinamike politike, shoqërore dhe transformime ekonomike, duke gërshetuar me nevojën për të luftuar dhunën ndaj grave.

Vëmendje më e gjerë ndaj dhunës kundër grave ndodhi në radhë të parë në kontekstin e Dekadës së Kombeve të Bashkuara për Gratë (1975-1985), kur më shumë organizata të grave u ndërlidhen me axhendën e OKB-së nëpërmjet konferencave ndërkombëtare dhe rajonale të grave, dhe më nishta zhvillimore për gratë. Plani Botëror i Veprimit, i miratuar në 1975 në Konferencën Botërore të Vitit Ndërkombëtar të Grave në Mexico City, identifikoi barazinë e plotë gjinore dhe eliminimin e diskriminimit gjinor ndërmjet objektivave kryesore, dhe tërhoqi vëmendjen në nevojën për mënyra të zgjidhjes së konflikteve në familje duke respektuar dinjitetin, barazinë dhe sigurinë të çdo anëtarit të familjes. Këto përpjekje vepruan si nxitje dhe inkurajim, duke dhënë shtytje në zgjerimin e të kuptuarit të dhunës ndaj grave. Si rezultat, janë zhvilluar norma dhe standarde ndërkombëtare për parandalim dhe luftim të dhunës ndaj grave, si dhe janë krijuar mekanizma monitorues dhe raportues. Sot pranohet që të drejtat e grave janë të drejtat e njeriut, ndërsa dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje janë forma të shkeljes së të drejtave të njeriut.

2.1 Të drejtat e grave si të drejtat e njeriut

Të drejtat e grave janë të drejtat e njeriut. Përkufizimi i të drejtave të njeriut paraqet në radhë të parë tërësinë e atyre të drejtave, të cilat çdo individ mund t'i gëzojë thjesht nga virtyti i të qenit njerëzor. Këto të drejta janë të patjetërsueshme, pra, ato nuk mund t'i mohohen askujt. Në thelb të të drejtave të njeriut qëndron parimi i dinjiteti njerëzor, i cili është i pacenueshëm dhe, si i tillë, duhet të respektohet dhe të mbrohet. Në radhë të parë shtetet kanë detyrim të

respektojnë, mbrojnë dhe përmbushin të drejtat e njeriut. Detyrimi për të respektuar nënkupton se shtetet duhet të përmbahen nga ndërhyrja ose kufizimi i gëzimit të të drejtave të njeriut. Detyrimi për të mbrojtur kërkon nga shtetet që të mbrojnë individë dhe grupe nga shkeljet e të drejtave të njeriut, dhe kërkon nga shteti që brenda territorit të tij të parandalojë dhunën. Detyrimi për të përmbushur nënkupton se shtetet duhet të ndërmarrin veprime pozitive për të garantuar, promovuar, dhe lehtësuar gëzimin e të drejtave, duke ofruar mjete juridike efektive për shkeljet e tyre. Ky obligim kërkon nga shteti që të ofrojë realizimin efektiv të të drejtave përmes masave adekuate ligjore, administrative, gjyqësore dhe faktike.

Në aspektin e parandalimit dhe luftimit të dhunës së bazuar në gjini dhe dhunës seksuale, të drejtat ndërkombëtare të njeriut kërkojnë që autoritetet vendore të ushtrojnë kujdes të duhur për parandalimin e dhunës ndaj grave, dhunës seksuale dhe dhunës në familje. Për ta përmbushur këtë standard të kujdesit të duhur, autoritetet duhet të miratojnë legjislacionin përkatës dhe të marrin masa të duhura për të parandaluar dhe mbrojtur nga të gjitha forma të dhunës, duke përfshirë mbrojtjen dhe kompensimin e viktimave, si dhe hetimin dhe ndjekjen penale të kryerësve të incidenteve të dhunës. Po ashtu, kërkohet nga shtetet që të marrin masa të nevojshme për fuqizimin e grave, dhe të nxisin dhe zbatojnë në mënyrë efektive politikat e barazisë midis burrave dhe grave duke luftuar paragjykimet, zakonet dhe praktikën që bazohen në idenë e inferioritetit të grave.

Koncepti i universalitetit është themelor për të drejtat e njeriut dhe kjo vlen në veçanti kur kemi të bëjmë me të drejtat e grave. Sot gjerësisht pranohet që *“të gjitha të drejtat e njeriut janë universale, të pandashme, recipocikisht të varura dhe të ndërlidhura.”*¹⁰ Në Konferencën Botërore e të Drejtave të Njeriut të mbajtur në Vjenë në vitin 1993, nën parullë *“Të gjitha të drejtat e njeriut për të gjithë”* dhuna kundër grave është njohur si një shkelje e të drejtave të njeriut. Dokumenti i miratuar gjatë kësaj konference theksoj që *“Të drejtat e njeriut, të grave dhe të vajzave janë një pjesë e patjetërsueshme, përbërëse dhe e pandashme e të drejtave universale të njeriut.”*¹¹ Konferenca ka apeluar në pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të grave në jetën politike, civile, ekonomike, sociale dhe kulturore dhe në çrënjosjen e të gjitha formave të diskriminimit në bazë të gjinisë. Po ashtu, Konferenca bëri thirrje për emërimin e një Raportuesi Special të OKB-së për Dhunë ndaj Grave, të emëruar në mars 1994 nga Komisioni

¹⁰ Deklarata dhe Programi i Veprimit i Konferencës Botërore e të Drejtave të Njeriut e mbajtur në Vjenë në vitin 1993, Neni 5. <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/Vienna.aspx>

¹¹ Po aty, Neni 18.

për të Drejtat e Njeriut të OKB-së. Raportuesi Special mbledh informacione mbi dhunën ndaj grave, si dhe rekomandon masat, mënyrat dhe mjetet në nivelin lokal, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për të eliminuar të gjitha format e dhunës kundër grave dhe për të korrigjuar pasojat e saj, me qëllim të krijimit të pajtimit të praktikave me normat ligjore ndërkombëtare në fushën e të drejtave të grave.¹²

2.2 Instrumentet gjithëpërfshirëse për të drejtat e njeriut

2.2.1 Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut,¹³ si katalog i parë i të drejtave të njeriut dhe i lirive fundamentale, thekson në nenin 1: “Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në pikëpamje të dinjitetit dhe të të drejtave,” ndërsa më tutje përcakton qartë që të drejtat dhe liritë e shpallura në Deklaratë i përkasin secilit “pa kurrfarë dallime në pikëpamje të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, mendimit politik ose çdo mendimi tjetër, të prejdardhjes kombëtare apo shoqërore, të pasurisë, të lindjes apo të ndonjë gjendje tjetër juridike.”¹⁴ Deklarata Universale garanton të drejtën në jetë, liri dhe siguri të njerëzve,¹⁵ dhe ndalon torturën si dhe trajtimin apo ndëshkimin mizor, çnjerëzor apo poshtërues.¹⁶ Ajo garanton mbrojtje të barabartë para ligjit për të gjithë, pa asnjë diskriminim.¹⁷ Klauzola kundër diskriminimit, nënkupton se çdo formë e dhunës kundër grave që mund të interpretohet si kërcënim për jetën e gruas, lirinë apo sigurinë e saj, ose që përbën torturë apo trajtim mizor, çnjerëzor ose degradues nuk është në përputhje me Deklaratën Universale.

2.2.2 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore

Përkushtimeve të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut i është dhënë forcë e mjaftueshme e cila është juridikisht e obligueshme me miratimin e Paktit Ndërkombëtar për të

¹²Për më shumë informata rreth mandatit dhe aktiviteteve të Raportuesit Special shih: <http://www.ohchr.org/EN/Issues/Women/SRWomen/Pages/SRWomenIndex.aspx>

¹³ E miratuar me 10 dhjetor 1948 nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së .

¹⁴ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 2.

<http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/AUniversalDeclarationHumanRightsfinal.pdf>

¹⁵ Po aty, neni 3.

¹⁶ Po aty, neni 5.

¹⁷ Po aty, neni 7.

Drejtat Civile dhe Politike, dhe Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.¹⁸ Në këto pakte definohej, me më shumë detaje se sa në Deklaratën Universale, një varg të drejtash dhe lirish dhe përcaktohet si obligim absolut dhe i menjëhershëm për të gjitha shtetet palë, që të respektojnë dhe të sigurojnë këto të drejta për të gjithë individët brenda territorit të tyre pa kurrfarë diskriminimi. Për mbrojtjen e grave nga dhuna në veçanti janë të rëndësishëm neni 2 (e drejta në mjete efektive juridike), neni 6 (e drejta në jetë), neni 7 (ndalimi i torturës dhe trajtimit mizor, çnjerëzor apo degradues), neni 9 (e drejta në liri dhe siguri të personave), neni 14 (e drejta në dëgjim të drejtë dhe publik nga ana e një tribunali kompetent, të pavarur dhe të paanshëm) dhe neni 26 (e drejta në barazi para ligjit dhe në mbrojtje të barabartë të ligjit, pa diskriminim) të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

Të dy pakte nënvizojnë obligimin e shteteve që të sigurojnë të drejtën e barabartë të burrit dhe të gruas për t'i gëzuar të gjitha të drejtat.¹⁹ Zbatimi i këtyre traktateve ndërkombëtare monitorohet nga Komiteti për të Drejtat e Njeriut dhe nga Komiteti për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Po ashtu, këto dy organe monitoruese nxjerrin komente të përgjithshme mbi interpretimin e konventave, dhe vlen të theksohet që tanimë instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut interpretohen nga një aspekt më i madh i ndjeshmërisë gjinore. Një shembull është Komenti i përgjithshëm nr. 28, nga Komiteti për të Drejtat e Njeriut, ku bëhet interpretimi për të drejtën e barabartë të burrave dhe grave në gëzimin e të gjitha të drejtave civile dhe politike përmes thjerrëzës së ndjeshmërisë gjinore. Nga shtetet kërkohet “jo vetëm të miratojnë masa mbrojtëse, por edhe masa pozitive në të gjitha fushat në mënyrë që të arrihet fuqizimi efektiv dhe i barabartë i grave.”²⁰ Ndërsa, Komiteti për të Drejta Ekonomike në Komentin e përgjithshëm nr. 22, për të drejtën e shëndetit seksual dhe riprodhues, të miratuar në 2016, nënvizon obligimin e shteteve që të miratojnë dhe zbatojnë ligje kundër dhunës së bazuar në gjini, si dhe të garantojnë mjete efektive juridike për shkeljet e shëndetit seksual.²¹

¹⁸ Këto dy instrumente janë miratuar në vitin 1966, dhe në vitin 1976, kanë hyrë në fuqi. Përmbajtjen e tyre shiko në:

<http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/ACovenantCivilPoliticalRights.pdf>;
<http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/AIntCovEconomicSocialCulturalRights.pdf>

¹⁹ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 2.1 dhe neni 3; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, neni 2.2 dhe neni 3.

²⁰ Komenti i Përgjithshëm 28, pika 3.

²¹ Komenti i Përgjithshëm 22, pika 49 (d) dhe (h).

2.2.3 Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Fundamentale të Njeriut

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Fundamentale të Njeriut është një traktat i hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin ligjor. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut mbikëqyrë zbatimin e Konventës. Megjithëse pa dyshim, të gjitha të drejtat që përmban konventa janë thelbësore për realizimin e të drejtave të grave, kur flitet për luftën kundër dhunës ndaj grave, mund të veçohen: neni 2 (e drejta në jetë), neni 3 (ndalimi i torturës dhe trajtimit mizor, çnjerëzor apo degradues), neni 5 (e drejta në liri dhe siguri), neni 6 (e drejta në dëgjim të drejtë dhe publik në kohë të arsyeshme nga ana e një tribunali kompetent, të pavarur, dhe të paanshëm të themeluar me ligj), neni 8 (e drejta në respektimin e jetës private dhe familjare) neni 13 (e drejta në mjete efektive juridike) dhe neni 14 (ndalimi i diskriminimit). Ndërsa neni 14 i referohet drejtave të parashikuar në Konventën Evropiane, Protokollin 12 i Konventës Evropiane garanton të drejtën për barazinë që qëndron e pavarur, duke parashikuar një zbatim krejtësisht të pavarur të parimit të mos-diskriminimit “për çdo të drejtë të përcaktuar me ligj.”

Rëndësia e posaçme e Konventës qëndron në faktin e krijimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Jurisprudenca e kësaj gjykate kohëve të fundit gjithnjë e më shumë analizon dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje përmes prizmes së të drejtave të njeriut. Këto aktgjykime të Gjykatës Evropiane nënvizojnë nevojën e autoriteteve shtetërore për vendosjen e masave efikase të mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje. Për më tepër, aktgjykimet përcaktojnë parimin se dështimi i autoriteteve vendase për ushtrimin e kujdesit të duhur në mbrojtjen e grave, të cilat janë viktima të dhunës në familje, përbën diskriminim në bazë të gjinisë dhe shkelje të të drejtave të gruas për mbrojtje të barabartë para ligjit.²² Gjykata Evropiane pranon që efekti i plotë i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut mund të arrihet vetëm me interpretimin e ndjeshëm gjinor dhe zbatimin e dispozitave të saj që merr në konsideratë pabarazitë faktike midis grave dhe burrave dhe mënyrën se si ato ndikojnë në jetërat e grave.

²² Shih, për shembull, aktgjykime *Kontrova kundër Slovasisë*, 31 maj 2007; *Bevacqua dhe S. kundër. Bullgarisë*, 12 qershor 2008; *Branko Tomašić dhe të tjerë kundër Kroacisë*, 15 janar 2009; *Opuz kundër Turqisë*, 9 qershor 2009; *Kalucza kundër Hungarisë*, 24 prill 2012; *Mudric kundër Moldovës*, 16 qershor 2013; *Rumor kundër Italisë*, 24 maj 2014, *M.G. kundër Turqisë*, 22 mars 2016, *Talpis kundër Italisë*, 2 mars 2017, *Bălșan kundër Romanisë*, 23 maj 2017, etj.

2.3 Instrumentet e specializuara për të drejtat e njeriut

Përveç instrumenteve gjithëpërfshirëse për të drejtat e njeriut, një sërë aktesh ndërkombëtare dhe instrumente të specializuara për të drejtat e njeriut në nivel ndërkombëtar dhe rajonal, paraqesin standarde gjerësisht të pranuar që garantojnë të drejtat e grave dhe të vajzave, dhe cilat shërbejnë si mjet për parandalimin e dhunës në baza gjinore.

2.3.1 Konventa për të Drejtat e Fëmijës

Konventa për të Drejtat e Fëmijës²³ thekson në nenin 19 se ndalohet çfarëdo lloj dhune ndaj fëmijëve. Konventa kërkon nga shtetet që të nxjerrin tërë legjislacionin e duhur, dhe të marrin të gjitha masat e përshtatshme administrative, shoqërore dhe edukative, për të mbrojtur fëmijën nga të gjitha format e dhunës fizike ose mendore, lëndim apo shpërdorim, trajtim mospërfillës apo të shkujdesur, keqtrajtim apo shfrytëzim, përfshirë abuzimin seksual, përderisa është nën përkujdesjen e prindit apo prindërve, kujdestarit apo kujdestarëve ligjor apo personave tjerë të cilët kujdesen për fëmijën.

Sipas Konventës, masat mbrojtëse përfshijnë, kur është e përshtatshme, procedura të efektshme për hartimin e programeve shoqërore për përkrahjen e nevojshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, si dhe forma të tjera parandalimi dhe identifikimi, siç janë raportimi, referimi, hetimi, dhe ndjekje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, duke përfshirë, nëse është e nevojshme, procedurat e ndërhyrjes gjyqësore.

2.3.2 Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)

Diskriminimi në përgjithësi dhe ai i bazuar në gjini në veçanti, është një fenomen që cenon thelbin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut. Për këtë arsye, vëmendja dhe kujdesi për të vendosur standarde në instrumentet ndërkombëtare për të parandaluar diskriminimin e grave kanë qenë kyçe në përpjekjet për t'u njohur të drejtat e grave në nivelin global. Komisioni i OKB-së për Status të Grave, si trup i themeluar në vitin 1946, për të monitoruar situatën e grave dhe për të promovuar të drejtat e grave, në vazhdimësi ka punuar në identifikimin e të gjitha fushave në të cilat grave i u është mohuar barazia me burrat, duke përgatitur një sërë dokumentesh, përfshirë një deklaratë e cila ka shprehur vullnetin politik për eliminimin e

²³ E miratuar nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 44/25 më 20 nëntor 1989, hyri në fuqi më 2 shtator 1990. <http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/AConRightsChild.pdf>

diskriminimit ndaj grave. Por, rezultatet kanë qenë të fragmentuara, sepse ka munguar një traktat i detyrueshëm për të adresuar diskriminimin kundër grave në mënyrë të plotë. Për këtë arsye, Komisioni vendosi të përgatisë një instrument ndërkombëtar gjithëpërfshirës dhe të detyrueshëm për të eliminuar diskriminimin ndaj grave. Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në dhjetor 1979,²⁴ dhe hyri në fuqi në shtator të vitit 1981. Sot është ratifikuar nga 189 shtete, përkatësisht më shumë se 90 % të vendeve anëtare të OKB-së të cilat janë shtete palë (shtete anëtare) të CEDAW.

Konventa CEDAW konsiderohet instrument ndërkombëtar më i rëndësishëm për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave, pasi që përcakton në mënyrë të detajuar çfarë duhet konsideruar si diskriminim ndaj grave, dhe përkufizon masat gjithëpërfshirëse të cilat duhet të ndërmerren për të eliminuar trajtimin e pabarabartë. Ajo është ndërtuar në 30 nene të ndarë në 4 kapituj. 16 Nene substanciale identifikojnë fushat kryesore të diskriminimit të gruas duke përcaktuar edhe rrugët e ndërhyrjes. Pjesa tjetër ka të bëjë me strukturat dhe procedurat e raportimit të Konventës CEDAW. Detyrimet e shteteve palë shtrihen, në mënyrë të veçantë, jo vetëm në jetën publike por edhe në jetën private.

Qëllimi i Konventës është njohja ligjore e të drejtave të grave dhe krijimi i barazisë faktike gjinore për gratë në të gjitha fushat e jetës, qofshin ato politike, ekonomike, sociale, kulturore, qytetare apo familjare, duke hequr të gjitha format e diskriminimit ndaj grave të kryera nga cilido person ose organizatë. CEDAW, në preambulën e saj, thekson: “Zhvillimi i plotë dhe i gjithanshëm i një vendi, mirëqenia e botës dhe çështja e paqes kërkojnë pjesëmarrjen maksimale të grave, në të njëjtat kushte me burrat, në të gjitha fushat.”

CEDAW përcakton standardet juridike për arritjen e barazisë gjinore përmes eliminimit të diskriminimit ndaj grave. Konventa e bën të qartë që gratë kanë të drejtën e një gëzimi të plotë dhe të barabartë të të gjitha drejtave të tyre njerëzore. Po ashtu, Konventa siguron bazën për realizimin e barazisë midis grave dhe burrave përmes sigurimit të qasjes së barabartë dhe përmes ofrimit të mundësive të barabarta. Si detyrim parësor për shtetet anëtare, CEDAW

²⁴ E miratuar nga Rezoluta 34/180 e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së me 18 dhjetor 1979, hyri në fuqi me 3 shtator 1981. Konventa është gjerësisht e njohur si CEDAW, sipas shkurtesës së titullit të saj në gjuhë angleze (Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women).

përcakton përmirësimin e pozitës së grave në shoqëri. Konventa po ashtu kërkon ndryshimin e qëndrimit tradicional ndaj gruas.

CEDAW është traktati i parë i të drejtave të njeriut i cili në mënyrë eksplicite adreson diskriminimin e shumëfishtë gjinor duke përkufizuar:

“Diskriminim ndaj grave” nënkupton çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e seksit, e që ka për pasojë ose për qëllim të komprometojë ose të asgjësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga gjendja e tyre martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër.”²⁵

Shtetet nuk duhet të lejojnë diskriminimin ndaj grave, dhe në veçanti obligohen:

- Të përfshijnë në kushtetutat e tyre kombëtare ose në ndonjë dispozitë tjetër ligjore të përshtatshme parimin e barazisë mes grave dhe burrave dhe të sigurojnë zbatimin praktik të këtij parimi;
- Të miratojnë masa ligjore dhe masa të tjera të përshtatshme, duke përfshirë edhe sanksione nëse është nevoja, për ndaljen e çdo diskriminimi ndaj grave;
- Të vendosin një mbrojtje gjyqësore të të drejtave të grave, mbi bazën e barabartë me burrat, dhe të sigurojnë, nëpërmjet gjykatave kompetente dhe institucioneve të tjera publike, mbrojtjen efektive të grave kundër çdo veprimi diskriminues;
- Të mos ndërmarrin asnjë veprim ose praktikë diskriminuese ndaj grave dhe të sigurojnë që autoritetet publike dhe institucionet publike t’i përmbahen këtij detyrimi;
- Të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave që ushtron ndonjë person, organizatë ose çfarëdo ndërmarrje;
- Të marrin të gjitha masat e përshtatshme, duke përfshirë legjislacionin, për të ndryshuar ose shfuqizuar ligjet ekzistuese, rregulloret, zakonet apo praktikatat të cilat përbëjnë diskriminimin ndaj gruas;
- Të shfuqizojnë të gjitha dispozitat penale që përbëjnë ndonjë diskriminim ndaj grave.

²⁵ CEDAW, neni 1.

Përveç masave të përshtatshme²⁶ në të gjitha fushat e jetës politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, në fushat në të cilat ekzistojnë disavantazhet afatgjata, shtetet mund të miratojnë masa të përkohshme speciale për të përshpejtuar progresin e barazisë gjinore dhe për të përfunduar diskriminimin. Këto masa (të ashtuquajtura masa pozitive, apo afirmative) nuk konsiderohen diskriminim, dhe duhet të ndërpriten kur arrihen objektivat e barazisë së mundësive dhe të trajtimit.²⁷

Më tutje, shtetet duhet të veprojnë për të ndryshuar stereotipet gjinore, dhe modelet sociale e kulturore të sjelljes që përjetësojnë diskriminimin, nënshtrojnë gratë dhe kufizojnë mundësitë e barabarta, me qëllim “që të arrijnë zhdukjen e paragjyqimeve dhe çfarëdo praktike tjetër zakonore, që mbështetet në idenë e inferioritetit ose të superioritetit të njëjës apo tjetrës gjini.”²⁸

Neni 6 i detyron shtetet të miratojnë masa ligjore për luftimin e të gjitha formave të trafikimit të grave dhe të shfrytëzimit të prostitucionit të grave, por edhe t'i ndërmarrin veprime dhe të gjitha masat të përshtatshme që ndikojnë në shkaqet dhe pasojat e këtyre dukurive për t'i parandaluar ato.

CEDAW garanton pjesëmarrje të barabartë të grave në politikë dhe në jetën publike. Shtetet obligohen të sigurojnë grave drejtën e votimit, pjesëmarrjen në përpunimin dhe zbatimin e politikave shtetërore; dhe të drejtën për të ushtruar të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisjes.²⁹ Po ashtu, garantohet barazia për të përfaqësuar qeveritë e tyre në arenën ndërkombëtare.³⁰

Sipas CEDAW, shtetet duhet ti garantojnë grave të drejta të barabarta me burrat në fushën e marrjes, ndërrimit dhe mbajtjes së shtetësisë.³¹ Për më tepër, shtetet duhet të sigurojnë që gratë dhe burrat kanë të njëjta të drejta në fushën e arsimimit, duke aprovuar të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin, dhe duke ofruar arsimim që lufton stereotipe gjinorë.³²

²⁶ Po aty, neni 3.

²⁷ Po aty, neni 4.

²⁸ Po aty, neni 5.

²⁹ Po aty, neni 7.

³⁰ Po aty, neni 8.

³¹ Po aty, neni 9.

³² Po aty, neni 10.

Neni 11 ndalon diskriminimin në fushën e të drejtave të punës, duke garantuar, mbi bazën e barazisë midis burrit dhe gruas, të drejtën e njëjtë në punësim dhe në realizimin e të gjitha drejtave që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, duke përfshirë të drejtën në shpërblim të njëjtë midis grave dhe burrave për punën e njëjtë, dhe të drejtën në sigurim dhe benefite sociale. Paragrafi 2 i këtij neni i referohet parandalimit të diskriminimit ndaj grave në bazë të statusit martesor dhe maternitetit, dhe mbron të drejtat e grave gjatë shtatzënisë dhe lehonisë. Vlen të theksohet që hendeku gjinor në realizimin e këtyre drejtave ende ekziston. Si shembull ilustrimi mund të shërbej kërkesa për pagesën e njëjtë për punën e njëjtë, e cila ende paraqet problem edhe për vende më të zhvilluara. Të dhëna statistikore tregojnë që në vende anëtare të BE-së, gratë fitojnë rreth 16% më pak në orë se sa burrat.³³

Për më tepër, CEDAW vërteton të drejtat e barabarta të grave në qasje ndaj kujdesit shëndetësor, dhe garanton mundësitë e barabarta në përdorim të shërbimeve shëndetësore duke përfshirë planifikimin familjar.³⁴ Po ashtu, shtetet palë duhet të eliminojnë diskriminimin ndaj grave në të gjitha fushat e jetës ekonomike dhe sociale, duke ofruar mundësitë dhe të drejtat e njëjta në fushën e ekonomisë, kulturës dhe sportit.³⁵ Konventa i referohet në veçanti pozitës së gruas në fshat, dhe parashikon një sërë masash për pjesëmarrjen e barabartë të grave në të gjitha aktivitetet në nivelin lokal.³⁶

CEDAW obligon shtetet palë të sigurojnë barazinë e grave dhe burrave para ligjit, si dhe të garantojnë zotësi të njëjta juridike, si një standard i domosdoshëm për realizimin e të drejtave të barabarta.³⁷

Gjithashtu, shtetet obligohen për të eliminuar diskriminimin në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me martesën dhe me marrëdhëniet familjare. Këtu përfshihen, ndër të tjera, e drejta e barabartë për të lidhur martesë dhe për të zgjedhur lirisht bashkëshortin; të drejtat e barabarta e bashkëshortëve gjatë dhe pas martesës; të drejtat e njëjta të bashkëshortëve lidhur me pronësinë, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e njëjta prindore, pavarësisht nga gjendja

³³ Zyra e statistikave të BE-së, EUROSTAT, http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Gender_pay_gap_statistics

³⁴ CEDAW, neni 12.

³⁵ Po aty, neni 13.

³⁶ Po aty, neni 14.

³⁷ Po aty, neni 15.

martesore. Shprehimisht theksohet që martesat e fëmijëve të mitur nuk kanë efekt juridik, dhe kërkohet nxerrja e ligjeve për të caktuar moshën minimale për martesë.³⁸

a) Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Gruas (Komiteti CEDAW)

Sipas dispozitave të CEDAW³⁹ është krijuar Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Gruas (Komiteti CEDAW), me qëllim që të monitorohet implementimi i Konventës dhe të shqyrtohen arritjet e shteteve në zbatimin e saj, duke krahasuar pajtueshmërinë e shteteve me obligimet e marra.

Komiteti CEDAW përbëhet nga njëzet e tre ekspertë dhe i raporton në baza vjetore Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Po ashtu, Komiteti mund të bëjë sugjerime e rekomandime të përgjithshme të bazuara në shqyrtimin e raporteve dhe të informacioneve që ka marrë nga shtetet palë. Shtetet paraqesin raporte periodike në Komitetin CEDAW (të paktën çdo katër vite, si dhe me kërkesën e Komitetit), duke raportuar progresin në zbatimin e CEDAW dhe në përmbushjen e rekomandimeve të dhëna nga Komiteti CEDAW. Komiteti bën rekomandime për çështjet për të cilat beson se shtetet palë duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje. OJQ-të gjithashtu mund të dorëzojnë raporte alternative (të ashtuquajtur 'raporte në hije') tek Komiteti CEDAW, duke treguar mangësitë dhe sfidat në zbatimin e Konventës CEDAW, që ndoshta nuk përmenden në raportin zyrtar të vendit të tyre. Përkrahja e OJQ-ve, sidomos atyre të grave, për të bërë monitorimin është një hap i rëndësishëm për të parë se a janë duke i përmbushur shtetet obligimet e tyre.

Në tetor të vitit 1999, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi Protokolin Fakultativ të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave dhe u bëri thirrje të gjitha shteteve palë të Konventës, të bëhen sa më parë palë edhe të këtij instrumenti. Protokoli hyri në fuqi në dhjetor 2000. Ky Protokol ka rëndësi të posaçme, sepse ofron mundësinë që Komitetit CEDAW t'i adresohen ankesa individuale për shkeljet e të drejtave të garantuara më CEDAW. Ankesat mund të paraqesin individët ose grupet e individëve që pretendojnë në shkelje të të drejtave, apo dikush tjetër me pëlqimin e tyre. Po ashtu, Protokoli i mundëson Komitetit CEDAW zbatimin e procedurave hetimore për shkelje sistematike ose të rënda të të drejtave. Protokoli Fakultativ forcon mekanizmat mbikëqyrës të Konventës, dhe

³⁸ Po aty, neni 16.

³⁹ Po aty, neni 17.

po ashtu parashikon obligimin e shteteve për sensibilizimin e opinionit publik për përmbajtjen e Konventës CEDAW.

Diskriminimi ndaj grave dhe dhuna janë të ndërlidhura ngushtë. Çështja e dhunës me bazë gjinore, edhe pse nuk është trajtuar në mënyrë specifike në CEDAW (përveç trafikimit dhe prostitucionit), është qartazi thelbësore për dispozitat e saj, ndërsa klauzolat kundër diskriminimit mundësojnë mbrojtjen e grave kundër dhunës. Rekomandimi i përgjithshëm nr. 12 të Komitetit CEDAW në vitin 1989 vuri në dukje detyrimin e shteteve për të mbrojtur gratë nga dhuna sipas neneve të ndryshme të Konventës CEDAW, dhe u kërkoi shteteve të përfshijnë informacione mbi incidente të dhunës në raporte të tyre. Për më tepër, Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 19, i cili është formuluar në vitin 1992 nga Komiteti, theksoj se dhuna me bazë gjinore është një formë diskriminimi që prek rëndë të drejtat e njeriut të grave.

Rekomandimi i përgjithshëm nr. 19 i Komitetit CEDAW, merret në tërësi me dhunën ndaj grave. Rekomandimi në mënyrë eksplicite thekson se dhuna në baza gjinore është një formë e diskriminimit që seriozisht pengon aftësitë e grave për të gëzuar të drejtat dhe liritë e tyre në bazat e barabarta me burrat. Këtë gjë shtetet anëtare duhet të kanë parasysh kur përpilojnë dhe shqyrtojnë ligjet dhe politikat e tyre. Gjithashtu, rekomandimi thekson që dhuna e bazuar në gjini paraqet diskriminim sipas kuptimit të nenit 1 të CEDAW.

Rekomandimi më tej thekson që dhuna ndaj grave është “dhunë e cila është drejtuar ndaj gruas për faktin se është grua dhe u drejtohet kryesisht grave, apo i prek gratë në mënyrë disproporcionale.” Shtetet duhet ta konsiderojnë dhunën në baza gjinore kur veprojnë dhe raportojnë sipas CEDAW. Për më tepër, sipas rekomandimit nr. 19 shtetet gjithashtu mund të jenë përgjegjëse për akte private nëse nuk veprojnë me kujdes të duhur për të parandaluar shkeljet e të drejtave ose për të hetuar dhe ndëshkuar aktet e dhunës dhe për të siguruar kompensimin.

Rekomandimi i përgjithshëm nr. 35 i Komitetit CEDAW, i nxjerrur në korrik 2017, përditëson Rekomandimin e përgjithshëm nr. 19. Ky rekomandim pranon se ndalimi i dhunës me bazë gjinore është bërë një normë e së drejtës zakonore ndërkombëtare, dhe zgjeron kuptimin e dhunës për të përfshirë shkeljet e të drejtave të shëndetit seksual dhe riprodhues. Rekomandimi nr. 35 rithekson nevojën për të ndryshuar normat sociale dhe stereotipet që mbështesin dhunën, dhe përcakton qartë nivele të ndryshme të përgjegjësisë së shtetit për veprimet dhe

mosveprimet e kryera nga aktorët shtetrorë, si dhe për dështime për të vepruar me kujdesin e duhur për të parandaluar dhunën të kryer nga subjektet private.

2.3.3 Deklarata për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave

Në fillim të viteve 1990, përpjekjet nga lëvizja e grave për të fituar njohje të dhunës ndaj grave si çështje e shkeljes së të drejtave të njeriut fituan vrullin. Në Konferencën Botërore për të Drejtat e Njeriut në Vjenë në vitin 1993, lëvizjet dhe OJQ-të të grave lobuan për të ripërcaktuar konturat e ligjit të të drejtave të njeriut për të përfshirë nevojat e grave. Ato prezantuan gati gjysmë milioni nënshkrime nga 128 vende duke kërkuar që dhuna ndaj grave të jetë e njohur si një shkelje e të drejtave të njeriut të grave.

Procesi i përfshirjes së dhunës ndaj grave në mënyrë të vendosur në axhendën ndërkombëtare arriti kulmin me miratimin e Deklaratës për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave në vitin 1993 nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së.⁴⁰ Miratimi i Deklaratës ka një rëndësi të veçantë. Deklarata për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave është instrument i parë ndërkombëtar që trajton në mënyrë eksplicite dhunën ndaj grave, duke krijuar standarde në drejtën ndërkombëtare për mbrojtjen e grave ndaj dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore dhe duke siguruar një kuadër për veprim. Deklarata pohon se dhuna ndaj grave pengon, dëmton ose i mohon grave gëzimin e të drejtave të tyre, dhe shpreh shqetësimin për shkak të dështimit për të mbrojtur gratë nga dhuna për një kohë të gjatë.

Deklarata për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, njih se:

- Dhuna ndaj grave është manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të fuqisë mes burrave dhe grave;
- Dominimi dhe diskriminimi ndaj grave nga ana e burrave ka çuar në parandalimin e përparimit të plotë të grave;
- Dhuna ndaj grave është një nga mekanizmat kryesorë socialë përmes të cilit gratë vihen në pozitë të varësisë në raport me burrat.

Deklarata për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave përkufizon dhunën ndaj grave si:

⁴⁰ E miratuar nga Rezoluta 48/104 e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së me 20 dhjetor 1993, në dispozicion në <http://www.un.org/documents/ga/res/48/a48r104.htm>

“çdo akt dhune me bazë gjinore që sjellë si pasojë ose që mund të sjellë si pasojë dëmtime ose vuajtje fizike, seksuale ose psikologjike tek gratë, duke përfshirë kërcënimin për akte të tilla, shtrëngimin ose privimin arbitrar të lirisë, pavarësisht nëse këto ndodhin në jetën publike apo private.”

Deklarata dallon dhunën ndaj grave si dhunë që ndodh brenda familjes, dhunë brenda komuniteti të përgjithshëm, dhe dhunë të kryer ose të aprovuar nga shteti. Ne këtë kuptim, Deklarata jep një përkufizim të plotë të dhunës ndaj grave, duke sqaruar:

“Dhuna ndaj grave duhet kuptuar se përfshin, por nuk kufizohet vetëm në:

- a) dhunën fizike, seksuale dhe psikologjike që ndodh brenda familjes, duke përfshirë edhe rrahjen, abuzimin seksual të fëmijëve femra në mjedisin familjar, dhunën që lidhet me pajën (prikën), përdhunimin martësor, gjymtimin gjenital të femrave si dhe praktika të tjera tradicionale të dëmshme për gruan, dhunën nga jo-bashkëshorti, dhe dhunën lidhur me shfrytëzimin;
- b) dhunën fizike, seksuale dhe psikologjike që ndodh brenda komunitetit të përgjithshëm, duke përfshirë përdhunimin, abuzimin seksual, ngacmimin seksual dhe frikësimin në punë, në institucionet arsimore dhe kudo, trafikimin e grave dhe prostitucionin e detyruar;
- c) dhunën fizike, seksuale dhe psikologjike të kryer ose të aprovuar nga shteti, kudo që ndodh.”

Deklarata jo vetëm që deklaron se aktorët shtetërorë duhet të përmbahen nga përfshirja në aktet e dhunës ndaj grave, por gjithashtu pohon që shtetet duhet të marrin masa afirmative për të parandaluar dhe të dënuar dhunën e kryer nga aktorët publikë dhe privatë dhe për të krijuar rrjete mbështetëse për t'u kujdesur për viktimat e dhunës së bazuar në gjini.

2.3.4 Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim

Në vitin 1995, Konferenca e Katërt Botërore për Gratë është mbajtur në Pekin. Konferenca kishte gjeneruar zotime globale për të avancuar barazinë gjinore. Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim, të miratuar unanimisht nga 189 shtete, krijuan një axhendë gjithëpërfshirëse për fuqizimin e grave dhe prezantuan një dokument të fuqishëm politik për barazinë gjinore. Në Deklaratën e Pekinit thuhet se “avancimi i grave dhe arritja e barazisë mes

grave dhe burrave janë çështje të të drejtave të njeriut dhe kusht për drejtësi sociale, dhe nuk duhet të shihen të izoluara si një çështje e grave.” Deklarata e Pekinit vendos synime dhe veprime strategjike për avancimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore në një sërë fushash kritike, përfshirë arsimimin, kujdesin shëndetësor, dhunën ndaj grave, gratë dhe mediat, mjedisin, gratë dhe ekonominë, pushtetin dhe vendimmarrjen, dhe mekanizmat institucional. Platforma e Pekinit për Veprim identifikon veprime specifike të cilat qeveritë duhet të ndërmarrin për të parandaluar dhe reaguar kundër dhunës ndaj grave. Përfundimi i dhunës është një nga fushat e veprimit prioritar, duke nënvizuar se dhuna ndaj grave është po ashtu si një shkelje e të drejtave të njeriut të grave edhe një pengesë për gëzimin e plotë e të gjitha të drejtave të grave. Fokusi është përqendruar në kërkimin e llogaridhënies nga shteti për veprime për të parandaluar dhe eliminuar dhunën ndaj grave. Platforma përfshin një përkufizim të shtrirë të formave të dhunës.

2.3.5 Rezoluta 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë e Këshillit të Sigurimit të OKB

Rezoluta 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë e Këshillit të Sigurimit të OKB-së,⁴¹ e miratuar në 2000, paraqet një moment historik në adresimin e dhunës ndaj grave në situatat e konfliktit të armatosur. Duke njohur nevojën për të zbatuar plotësisht ligjet që mbrojnë të drejtat e grave dhe vajzave gjatë dhe pas konfliktit të armatosur, Rezoluta u bën thirrje palëve të konfliktit të armatosur për masa të veçanta për të mbrojtur gratë dhe vajzat nga dhuna me bazë gjinore, në veçanti nga dhunimi dhe çdo lloji të abuzimit seksual. Rezoluta gjithashtu theksoi përgjegjësinë e të gjitha shteteve për t'i dhënë fund mosndëshkimit, duke siguruar ndjekjen penale të kryesve të krimeve.

2.3.6 Rezoluta e OKB-së për Eliminimin e Dhunës në Familje ndaj Gruas

Në vitin 2004, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi Rezolutën për Eliminimin e Dhunës në Familje ndaj Gruas.⁴² Për herë të parë, në nivel global, me këtë rezolutë pranohet që dhuna në familje është “shqetësim publik.” Rezoluta bën thirrje shteteve që të ndërmarrin veprime serioze për të mbrojtur viktimat dhe për të parandaluar dhunën në familje. Gjithashtu

⁴¹ Rezoluta 1325 (2000) e miratuar nga Këshilli i Sigurimit në mbledhjen e tij 4213, më 31 tetor 2000, <http://www.un-documents.net/sr1325.htm>

⁴² Rezoluta 58/147 e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së për eliminimin e dhunës në familje ndaj gruas, A/RES/58/147, 19 shkurt 2004. <http://www.worldlii.org/int/other/UNGARsn/2003/185.pdf>

Rezoluta kërkon sigurimin e mbrojtjes më të madhe për gratë nëpërmjet urdhrave për kufizimin e bashkëshortëve të dhunshëm.

2.3.7 Zbatimi i drejtpërdrejtë i instrumenteve ndërkombëtare

Në bazë të nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, instrumentet më të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut janë drejtpërsëdrejti të aplikueshme në Kosovë dhe në rast të kundërthënies, kanë epërsi mbi legjislacionin vendor. Këtu përfshihen Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW); Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut; Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike; dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës. Për më tepër, sipas nenit 53 të Kushtetutës, të drejtat njeriut dhe liritë themelore, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

3. Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit)

3.1. Historiku

Këshilli i Evropës, si organizatë ndërqeveritare rajonale me 47 shtete anëtare, është organizatë kryesore evropiane për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, demokraci dhe sundim të ligjit. Përpjekjet e vazhdueshme për të promovuar të drejtat e grave, kanë rritur kuptimin global që ushtrimi efektiv i të drejtave të grave nënkupton luftimin e dhunës ndaj grave. Këto përpjekje janë intensifikuar sidomos që nga vitet e 90-ta, dhe njëkohësisht me nisma globale, Këshilli i Evropës ka ndërmarrë një varg iniciativash për nxitjen e mbrojtjes së grave nga dhuna. Në veçanti, këto iniciativa kanë rezultuar me miratimin e Rekomandimit Rec (2002)⁵ të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e grave kundër dhunës, dhe Rekomandimin Rec (2007)¹⁷ mbi standardet dhe mekanizmat e barazisë gjinore. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës gjithashtu ka dëshmuar një qëndrim të fortë politik kundër të gjitha formave të dhunës ndaj grave. Një numër i madh rezolutash dhe rekomandimesh që bënin thirrje për standarde ligjërish të detyrueshme për parandalim dhe mbrojtje si dhe për ndjekjen penale të formave më serioze dhe më të përhapura të dhunës së bazuar në gjini, janë miratuar.

Për të dhënë një shtysë të re për çrrënjosjen e dhunës, nga 2006-2008, është organizuar një fushatë e gjerë evropiane për ta tërhequr vëmendjen e ligjberësve dhe opinionit të gjerë ndaj nevojës për të luftuar dhunën ndaj grave, duke përfshirë dhunën në familje dhe dhunën seksuale. Vrojtimet dhe studimet treguan madhësinë e problemit. Në anën tjetër fushata në veçanti zbuloi se sa përgjigjet kombëtare ndaj dhunës kundër grave dhe dhunës në familje ndryshonin në të gjithë Evropën. Nevoja për standarde të harmonizuara ligjore për të siguruar që viktimat përfitojnë nga niveli i njëjtë i mbrojtjes kudo në Evropë, u bë e dukshme. Vullneti politik për të vepruar është rritur, dhe filluan diskutimet rreth nevojës për të fuqizuar mbrojtjen e grave nga dhuna dhe dhuna në familje, veçanërisht nga dhuna e partnerit intim. Këshilli i Evropës vendosi që ishte e nevojshme të caktohen standarde gjithëpërfshirëse. Në dhjetor 2008, Këshilli themeloi një grup ekspertësh për të përgatitur konventën e cila do të rregulloj çështjen e parandalimit dhe luftimit të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Drafti i konventës është finalizuar në dhjetor 2010.

Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) është miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës më 7 prill 2011.⁴³ Ajo u hap për nënshkrime më 11 maj 2011, me rastin e takimit të Komitetit të Ministrave në Stamboll, dhe hyri në fuqi më 1 gusht 2014.

3.2 Përmbledhje

Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje është traktati i parë evropian i cili merret në mënyrë komplekse dhe gjithëpërfshirëse me çështjen e dhunës ndaj grave. Njëkohësisht, ajo është edhe traktati më i përparuar ndërkombëtar i cili trajton në hollësi dhunën si një shkelje specifike e të drejtave të grave. Konventa përbën dispozita të hollësishme lidhur me masat që shtetet duhet të marrin për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, për mbrojtjen e viktimave dhe për ndëshkimin e kryerësve të veprave penale.

Konventa e njeh dhunën ndaj grave si shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut dhe si formë diskriminimi. Konventa po ashtu thekson se dhuna ndaj grave është konsekuencë e pabarazisë shoqërore dhe vijon për shkak të kulturës së mostolerancës dhe mohimit. Konventa e Stambollit

⁴³ Tekstin e Konventës shiqo në: <https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/text-of-the-convention>

bën një thirrje të re për barazi ndërmjet burrave dhe grave. Si e tillë, Konventa është një traktat i të drejtave të njeriut, dhe një instrument për barazi më të madhe gjinore.

Në të njëjtën kohë, Konventa është traktati i parë ndërkombëtar që përmban një përkufizim të gjinisë, duke nënvizuar që ekziston një kontekst social i cili përcakton rolet dhe sjelljet e grave dhe burrave. Konventa kërkon një ndryshim të sjelljeve, roleve dhe stereotipeve gjinore që e bëjnë të pranueshme dhunën ndaj grave, duke i u bërë thirrje pjesëtarëve të shoqërisë, në veçanti burrave dhe djemve, t'i ndryshojnë sjelljet.

Për herë të parë në histori, Konventa e Stambollit e bën të qartë se dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje nuk mund të konsiderohen më si një çështje private, por që shtetet kanë detyrim për të trajtuar atë në mënyrë efektive, qoftë në kohë paqeje ose në situata të konfliktit të armatosur. Sipas Konventës, dhuna ndaj grave duhet të konsiderohet si vepër penale dhe të dënohet sipas ligjit, duke përfshirë dhunën fizike, seksuale dhe psikologjike. Po ashtu, për herë të parë, nga shtetet kërkohet të inkriminojnë format e ndryshme të dhunës kundër grave, dhe të përfshijnë ngacmimin seksual, gjymtimin gjenital femëror, martesën e detyruar, abortin e detyruar dhe sterilizimin e detyruar, si vepra penale në sistemet e tyre ligjore.

Me pranimin e Konventës, shtetet palë detyrohen të ndryshojnë ligjet e tyre, të aprovojnë masa praktike apo legjislative, dhe të shpërndajnë burime për të parandaluar dhe trajtuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje në mënyrë efektive. Me pikësynimin për mbrojtjen e grave nga dhuna, Konventa parashikon standarde për një sërë shërbimesh mbështetëse për fuqizimin e viktimave dhe aftësimin e tyre për t'u mëkëmbur, duke specifikuar llojet e shërbimeve që duhen vënë në dispozicion dhe qasjen e ndjeshme gjinore që duhet aplikuar në ofrimin e këtyre shërbimeve.

Konventa bën thirrje për një qasje holistike dhe të koordinuar të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, duke kërkuar përfshirjen e të gjitha institucioneve dhe shërbimeve përkatëse, duke përfshirë bashkëpunimin e institucioneve me OJQ-të. Për OJQ-të, Konventa siguron një bazë të fuqishme për avokim dhe kërkim të një përgjigjeje të përmirësuar të qeverisë kundër dhunës ndaj grave, duke treguar fushat e ndërhyrjes. OJQ-të gjithashtu mund të përdorin Konventën si një instrument ligjor i reagimit të duhur kundër dhunës ndaj grave, i cili njëkohësisht shërben si një tregues për zhvillimin e programeve të ndërgjegjësimit, parandalimit dhe të mbrojtjes.

Konventa synon të krijon një Evropë pa dhunë kundër grave dhe pa dhunë në familje dhe mbron të gjitha gratë dhe vajzat, pavarësisht nga mosha, raca, feja, përkatësia kombëtare, origjina sociale, orientimi seksual, statusi civil, statusi emigranti ose refugjati. Po ashtu, shtetet inkurajohen të zbatojnë konventën dhe për viktime të tjera të dhunës në familje, si burrat, fëmijët dhe të moshuarit.

Monitorimi i zbatimit të Konventës bëhet nga një grup ekspertësh të pavarur, të ashtuquajtur “Grupi i ekspertëve për masat kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (GREVIO), dhe Komiteti i Palëve, i cili është një organizëm politik i përbërë nga përfaqësues të shteteve palë në Konventë.

3.3 Qëllimet dhe përkufizimet

Qëllimet e Konventës, të përcaktuara më nenin 1, janë:

- a. “mbrojtja e grave nga të gjitha format e dhunës, dhe parandalimi, ndjekja penale dhe eliminimi i dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;
- b. kontributi ndaj eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe promovimi i barazisë thelbësore midis burrave dhe grave, duke përfshirë fuqizimin e grave;
- c. hartimi i një kuadri gjithëpërfshirës politikash dhe masash për mbrojtjen dhe ndihmën për të gjitha viktimat e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;
- d. nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar, me synim eliminimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;
- e. ofrimi i mbështetjes dhe ndihmës për organizatat dhe agjencitë e zbatimit të ligjit për të bashkëpunuar në mënyrë efektive, me qëllim miratimin e një përqsajeje të integruar për të eliminuar dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.”

Konventa bënë të qartë që ajo zbatohet për të gjitha forma të dhunës kundër grave, duke përfshirë dhunën në familje. Po ashtu, duke pranuar se burrat gjithashtu mund të jenë viktime të dhunës në familje, theksohet që dhuna në familje prek gratë në mënyrë disproporcionale, sepse gratë dhe vajzat janë më të ekspozuara sesa burrat ndaj një rreziku më të lartë të dhunës gjinore. Edhe pse shtetet palë inkurajohen të zbatojnë Konventën për të gjitha viktimat e dhunës në familje, pra edhe për aktet e dhunës ndaj burrave dhe fëmijëve, fokusi primar është tek gratë dhe vajzat (neni 2).

Në nenin 3 Konventa ofron përkufizimet. Përkufizimi i dhunës ndaj grave sqaron që kjo formë e dhunës paraqet, në të njëjtën kohë, shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi. Dëmtimet ekonomike janë përfshira gjithashtu, për dallim nga përkufizimet e mëparshme. Në këtë drejtim shpjegohet:

“**dhunë kundër grave**” kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private.”

Konventa siguron një përkufizim të shtrirë të dhunës në familje që mbulon aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike, ndërmjet anëtarëve të familjes ose njësisë shtëpiake, pavarësisht nga lidhja biologjike ose ligjore dhe fakti nëse ekziston një jetë e përbashkët, apo jo. Përkufizimi është neutral ndaj gjinisë, dhe përfshin viktimat dhe kryerësit e dhunës së të dy gjinive, si më poshtë:

“**dhunë në familje**” nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish bashkëshortëve ose partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.”

Si viktimë përcaktohet çdo person fizik që i nënshtrohet dhunës kundër grave dhe dhunës në familje.

Konventa vendos detyrimin për të parandaluar dhe të luftuar dhunën kundër grave në kuadrin më të gjerë të arritjes së barazisë midis grave dhe burrave. Për këtë arsye hartuesit konsideruan të rëndësishme ta përkufizojnë juridikisht, për herë të parë në një traktat ndërkombëtar, konceptin e gjinisë, për të mundësuar dhënien e një përkufizimi të dhunës përmes perspektives gjinore.

“**gjini**” nënkupton rolet e ndërtuara në kontekstin social, sjelljet, aktivitetet dhe atributet që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për burrat dhe gratë;

“**dhunë gjinore kundër grave**” nënkupton dhunën që drejtohet kundër një gruaje për faktin se ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë disproporcionale.”

Të vetëdijshëm për faktin se shumë akte të dhunës kryhen ndaj vajzave, hartuesit nuk synonin të kufizonin zbatueshmërinë e Konventës vetëm për viktimat e moshës madhore. Prandaj në mënyrë eksplicite theksohet se termi ‘gra’ përfshin edhe vajzat nën moshën 18 vjeç.

3.4 Të drejtat themelore, barazia dhe mosdiskriminimi

Konventa e Stambollit pranon që dhuna gjinore ndaj grave përbën “shkelje të rëndë të të drejtave të grave dhe vajzave dhe pengesë kryesore për arritjen e barazisë midis burrave dhe grave.”⁴⁴ Shtetet marrin përsipër të përfshijnë perspektivën gjinore në zbatimin e Konventës dhe të nxisin dhe zbatojnë në mënyrë efektive politikat e barazisë midis burrave dhe grave, dhe fuqizimin e grave.⁴⁵

Neni 4 nënvizon të drejtën e çdo personi për të jetuar pa dhunë si në sferën publike ashtu edhe në atë private. Parimi bazë i Konventës është zbatimi i saj pa diskriminim. Të gjitha drejtat sipas Konventës sigurohen “pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjine kombëtare ose sociale, përkatësie në një pakicë kombëtare, pasurie, lindjeje, orientimi seksual, identiteti gjinor, moshe, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar, statusi civil, statusi emigranti ose refugjati ose statusi tjetër.”⁴⁶

Diskriminimi ndaj grave krijon një atmosferë përkrahjeje, mbarështimi dhe tolerance ndaj dhunës. Për këtë arsye, parimi i barazisë substanciale midis burrave dhe grave kërkon nga shtetet jo vetëm të sanksionojnë të gjitha format e diskriminimit ndaj grave, por edhe të

⁴⁴ Konventa e Stambollit, preambula.

⁴⁵ Po aty, neni 6.

⁴⁶ Po aty, neni 4.3

shprehin parimin e barazisë në kushtetutat e tyre dhe në legjislacion, dhe të sigurojnë realizimin e tij praktik duke shfuqizuar ligje dhe praktika diskriminuese.⁴⁷

3.5 Detyrimet e shtetit

Sipas së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, shteti ka detyrime negative dhe detyrime pozitive: zyrtarët e shtetit duhet të respektojnë ligjin dhe të përmbahen nga kryerja e veprimeve të gabuara dhe duhet t'i mbrojnë individët nga shkeljet e të drejtave të cilat kryhen nga akterët joshitetëror. Sipas nenit 5 të Konventës së Stambollit, autoritetet shtetërore nuk duhen të përfshihen në akte dhune ndaj grave, ndërsa shteti obligohet për marrjen e masave të nevojshme legjislative dhe të tjera, për të parandaluar, hetuar, dënuar dhe siguruar kompensim për akte dhune të cilët kryhen nga akterë joshitetërorë. Nga shteti kërkohet reagimi holistik ndaj dhunës kundër grave, me miratimin e politikave mbarëkombëtare efektive, gjithëpërfshirëse dhe të bashkërenduara, të cilat gjithmonë vendosin të drejtat e viktimës në qendër të të gjitha masave.⁴⁸ Për zbatimin e politikave dhe masave, shtetet duhet të shpërndajnë burimet e përshtatshme financiare dhe njerëzore, dhe të caktojnë një ose më shumë organe zyrtare përgjegjëse për bashkërendimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe masave për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës.⁴⁹

Neni 9 është i rëndësishëm për OJQ-të, sepse parashikon obligimin e shteteve të “pranojnë, nxisin dhe mbështesin, në të gjitha nivelet, punën e organizatave përkatëse joqeveritare dhe të shoqërisë civile, aktive në luftën e dhunës kundër grave dhe krijimin e bashkëpunimit efektiv me këto organizata.” Qëllimi i këtij neni është të theksojë kontributin e rëndësishëm të OJQ-ve për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës ndaj grave. Prandaj, duke përdorur ekspertizën e OJQ-ve, dhe duke i përfshirë ato si partnerë në bashkëpunim, mundësohet zbatimi i politikave gjithëpërfshirëse të qeverisë. Hulumtimet tregojnë qartë se vendet me më shumë OJQ të grave, marrin hapa më efektive për të luftuar dhunën kundër grave dhe dhunën në familje. Barazia në shoqëri mund të arrihet kur gratë dhe vajzat inkurajohen të marrin pjesë në të gjitha nivelet dhe kur ato organizohen për të kërkuar të drejtat e tyre, duke përfshirë të drejtën për të mos i u nënshtruar dhunës.

⁴⁷ Po aty, neni 4.2

⁴⁸ Po aty, neni 7.

⁴⁹ Po aty, neni 10.

Mbledhja sistematike dhe adekuate e të dhënave ka qenë prej kohësh e njohur si një komponent thelbësor gjatë hartimit të politikave efektive në fushën e parandalimit dhe luftimit të të gjitha formave të dhunës kundër grave. Me qëllim të hartimit të politikave të bazuara në dëshmi dhe për të vlerësuar efikasitetin e masave të marra, kërkohet mbledhja e të dhënave statistikore të ndara në intervale të rregullta dhe përkrahja e studimeve kërkimore në fushat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.⁵⁰

3.6 Parandalimi

Për të parandaluar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, Konventa e Stambollit kërkon ndryshimin e sjelljeve, roleve dhe stereotipeve gjinore që e bëjnë të pranueshme dhunën ndaj grave, duke i obliguar shtetet që të “marrin masat e nevojshme për të promovuar ndryshime në modelet sociale dhe kulturore të sjelljes së grave dhe burrave, me synim çrënjësues dhe paragjykimëve, zakoneve, traditave dhe të gjitha praktikave të tjera që bazohen në idenë e inferioritetit të grave ose në rolet e stereotipizuara për burrat dhe gratë.”⁵¹

Parandalimi bëhet edhe përmes miratimit të legjislacionit dhe masave të tjera të përshtatshme dhe me inkurajim të të gjithë anëtarëve të shoqërisë, veçanërisht duke vetëdijësuar burra dhe djem, që të kontribuojnë aktivisht në parandalimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave. Po ashtu, kërkohet rritja e ndërgjegjësimit për format e ndryshme të dhunës dhe për pasojat e tyre; përfshirja e çështjeve të barazisë gjinore në kurrikulat e të gjitha niveleve të arsimit; trajnimi i profesionistëve që punojnë me viktimat apo me kryesit e akteve të dhunës.⁵² Konventa kërkon edhe ndërhyrjen parandaluese dhe zhvillimin e programeve që synojnë edukimin e autorëve të dhunës në familje që të përdorin një sjellje jo të dhunshme në marrëdhëniet ndërpersonale, me synim parandalimin e dhunës së mëtejme.

3.7 Mbrojtja dhe mbështetja

Nëse masat parandaluese kanë dështuar, dhe kanë ndodhur incidentet e dhunës, është e rëndësishme që viktimave dhe dëshmitarëve t'u sigurohet mbrojtja nga dhuna e mëtejme dhe t'u ofrohet mbështetja. Mbështetja nënkupton ndërhyrjen dhe mbrojtjen e policisë, si dhe shërbimet e specializuara mbështetëse si strehimore, linja telefonike etj. Kjo gjithashtu do të

⁵⁰Po aty, neni 11.

⁵¹ Po aty, neni 12.

⁵² Po aty, nenet 13-15.

thotë të sigurohet që shërbimet sociale të përgjithshme kuptojnë realitetet dhe shqetësimet e viktimave të dhunës dhe t'i mbështesin ato për të rifilluar dhe rindërtuar jetën e tyre. Është me rëndësi që viktimave të ju ofrohen më kohë informacione të mjaftueshme, në një gjuhë që kuptojnë, në lidhje me shërbimet mbështetëse dhe masat ligjore që janë në dispozicion.⁵³ E drejta në informim është e plotësuar më të drejtën për ndihmë juridike falas për viktimat, e cila duhet të sigurohet nga shteti.⁵⁴

Sipas nenit 18 të Konventës së Stambollit, shtetet marrin masa të nevojshme legislative ose masa të tjera për të mbrojtur të gjitha viktimat nga akte të mëtejshme dhune. Këto masa duhen:

- të bazohen në një perceptim gjinor të dhunës kundër grave dhe dhunës në familje dhe të fokusohen tek të drejtat e njeriut dhe siguria e viktimës;
- të bazohen në një përqsasje të integruar;
- të synojnë shmangien e viktimizimit dytësor;
- të synojnë fuqizimin dhe pavarësinë ekonomike të grave, viktimat të dhunës;
- të lejojnë, sipas rastit, një gamë mbrojtjeje dhe shërbimesh mbështetëse që duhet të vendosen në të njëjtat ambiente;
- të trajtojnë nevojat specifike të personave të pambrojtur, duke përfshirë viktimat fëmijë dhe t'u vihen në dispozicion.”⁵⁵

Konventa e Stambollit bën dallimin ndërmjet shërbimeve mbështetëse të përgjithshme dhe të specializuara. Shërbimet mbështetëse të përgjithshme janë ato që lehtësojnë rehabilitimin e viktimave dhe duhet të përfshijnë shërbime të tilla si këshillime ligjore dhe psikologjike, ndihmë financiare, strehim, arsimit, trajnim dhe ndihmë në gjetjen e punës, si dhe qasje në shërbime sociale dhe shërbime shëndetësore.⁵⁶ Këto shërbime nuk parashikohen posaçërisht vetëm për të mirën e viktimave, por i shërbejnë publikut në përgjithësi. Ndërsa, shërbimet mbështetëse të specializuara janë të specializuara për ofrimin e mbështetjes dhe asistencës së përshtatur sipas nevojave të viktimave të formave specifike të dhunës ndaj grave apo dhunës në familje. Shërbimet e specializuara përfshijnë numrin e mjaftueshëm të strehimoreve, linja telefonike falas të pandërprerë mbarëkombëtare (24/7) për të ofruar konsulencë, dhe mbështetje për viktimat e dhunës nëpërmjet qendrave referuese të cilat ofrojnë shërbime mjekësore dhe

⁵³ Po aty, neni 19.

⁵⁴ Po aty, neni 57.

⁵⁵ Po aty, neni 18.3.

⁵⁶ Po aty, neni 20.

mjekoligjore, si dhe mbështetje psikosociale.⁵⁷ Pjesa e madhe e shërbimeve të specializuara mund të ofrohen nga OJQ-të.

Po ashtu, edhe pse pjesa më e madhe e viktimave të dhunës familjare janë gra, është me rëndësi që të pranohet ndikimi që kjo dhunë mund të ketë tek fëmijët. Në shumë raste, kërkohet prej fëmijëve të dëshmojnë për rastet e dhunës. Të drejtat dhe nevojat e tyre duhen të merren në konsideratë dhe duhet të vihen në dispozicion masa të specializuara mbështetëse dhe psikosociale në interes më të mirë të fëmijës.⁵⁸

3.8 Mjete dhe masa ligjore

Shtetet duhen të ofrojnë viktimave mjete ligjore të mjaftueshme civile kundër kryesit të veprës penale (siç janë urdhra mbrojtëse), dhe kundër autoriteteve shtetërorë nëse ata nuk kanë përmbushur detyrat e tyre për të parandaluar dhunën apo për të mbrojtur viktimën.⁵⁹ Viktimat kanë të drejtë për të kërkuar kompensim nga kryesit e dhunës për çdo shkelje e të drejtave të tyre, ndërsa viktimat që kanë pësuar dëme të rënda trupore apo dëmtim të shëndetit, kanë drejtë në kompensim nga shteti.⁶⁰ Incidente të dhunës duhet të merren parasysh kur merren vendimet për kujdestarinë dhe për të drejtat e vizitës ose kontaktit me fëmijë, duke siguruar të mos rrezikohet siguria e viktimës apo fëmijëve (neni 31).

Konventa e Stambollit kërkon nga shtetet të marrin masa të nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e dhunës psikologjike, cila definohet si dëmtim i qëllimshëm të integritetit psikologjik të një personi nëpërmjet shtrëngimit ose kërcënimeve (neni 33). Ndonëse tentimi i hartuesve ishte që të penalizohet dhuna psikologjike, shtetet mund të deklarojnë se rezervojnë të drejtën për të parashikuar sanksionet jo-penale për këtë lloj dhune.⁶¹

Sipas nenit 34, shtetet marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e përfshirjes së qëllimshme e të vazhdueshme në sjellje kërcënuese ndaj një personi tjetër. Edhe këtu shtetet mund të deklarojnë se rezervojnë të drejtën për të përcaktuar sanksionet jo-penale, për sa kohë që ato janë efektive, proporcionale dhe bindëse.⁶²

⁵⁷ Po aty, nenet 22-25.

⁵⁸ Neni 26.

⁵⁹ Neni 29.

⁶⁰ Neni 30.

⁶¹ Neni 78, paragrafi 3.

⁶² Po aty.

Për më tutje, Konventa obligon shtetet të garantojnë dënimin e dhunës fizike (neni 35) dhe dhunës seksuale (neni 36). Raporti shpjegues i Konventës sqaron: “dhunë fizike” i referohet një dëmtimi trupor të pësuar si rezultat i zbatimit të forcës fizike së drejtpërdrejtë dhe të paligjshme. Konventa përkufizon dhunën seksuale si “a) përfshirja në depërtim të detyruar vaginal, anal ose oral të një natyre seksuale, në trupin e një personi tjetër me pjesë trupore ose objekte; b) përfshirja me një person në akte të tjera të detyruara të një natyre seksuale; c) nxitja që një person tjetër të përfshihet me një person të tretë në akte të detyruara të një natyre seksuale.” Dhuna fizike dhe dhuna seksuale duhen të sanksionohen me ligj penal.

Neni 37 ndëshkon martesat e detyruara. Shtetet duhet të garantojnë inkriminimin të detyrimit të një të rrituri ose fëmije për të lidhur martesë. Martesat e detyruara mund të shpallën të pavlefshme, të anulohen ose të zgjidhen, pa barrën e panevojshme financiare apo administrative për viktimën.⁶³

Shtetet po ashtu detyrohen të parashikojnë në legjislacionin e tyre vepra penale për akte të gjymtimit të organeve gjinitale femërore (neni 38), abortit pa pëlqim dhe sterilizimit të detyruar (neni 39). Ndërsa ngacmimi seksual (neni 40) përkufizohet si: “çdo formë sjelljeje e padëshiruar verbale, jo verbale ose fizike e një natyre seksuale, me qëllimin ose efektin e shkeljes së dinjitetit të një personi, veçanërisht kur krijohet një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues.” Shtetet mund të zgjedhin të merren me ngacmimet seksuale ose me ligji penal, ose me sanksione administrative ose sanksione të tjera ligjore.

Konventa e Stambollit për më tej përcakton që kultura, zakoni, feja, tradita ose i ashtuquajtimi “nder” nuk mund të konsiderohen justifikime për akte dhune. Kjo në veçanti nënkupton pretendime që viktima ka shkelur normat ose zakonet kulturore, fetare, sociale ose tradicionale të sjelljes së duhur.⁶⁴

Për më tepër, veprat penale të përcaktuara në pajtim me Konventën zbatohen pavarësisht nga natyra e marrëdhënieve ndërmjet viktimës dhe kryerësit.⁶⁵ Rëndësia e kësaj dispozite qëndron në faktin se numri më i madh i veprave penale të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje

⁶³ Po aty, neni 32.

⁶⁴ Po aty, neni 42.

⁶⁵ Po aty, neni 43.

kryhen zakonisht nga anëtarë të familjes, bashkëshorti apo partnerët intim të viktimës. Në të kaluarën, ka shumë shembuj që tregojnë se janë bërë përjashtimet në ndjekjen penale të rasteve të tilla. Shembulli më i spikatur është përdhunimi brenda martesës.

Shtetet duhet të sigurojnë që të gjitha veprat penale të përcaktuara në pajtim me Konventën, dënohen me sanksione efektive, proporcionale dhe frenuese, duke marrë parasysh shkallën e kryerjes së tyre.⁶⁶

Neni 48 i Konventës ka një rëndësi të veçantë, sepse në mënyrë eksplicite ndalon proceset e detyrueshme alternative të zgjidhjes së konflikteve, duke përfshirë ndërmjetësimin dhe pajtimin, në lidhje me të gjitha format e dhunës të mbuluara nga Konventa. Rrjedhimisht, kërkohet nga shtetet të ndalojnë, si në procedura penale ashtu edhe në procedura civile, pjesëmarrjen e detyrueshme në çdo proces alternativ të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Konventa e Stambollit më tutje parashikon hetime efektive dhe procedura gjyqësore pa vonesë, që ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme dhe të menjëhershme për viktimat. Gjatë të gjitha fazave të procedimeve penale duhet të merren parasysh të drejtat e viktimës. Për më tepër, të gjitha autoritete relevante duhet të vlerësojnë në mënyrë efektive rrezikun e sigurisë me të cilin përballet një viktimë e veçantë dhe, nëse është e nevojshme, të ofrojnë mbështetje dhe siguri të koordinuar. Në situata të rrezikut të menjëhershëm, autoritetet kompetente duhet të kenë kompetenca për të lëshuar urdhra të jashtëzakonshëm të ndalimit, për të parandaluar, për një periudhë të mjaftueshme, kontaktet e kryesit të dhunës me viktimën.⁶⁷ Po ashtu, shtetet duhet të sigurojnë mundësi për të nxjerrë urdhra të përshtatshëm shtrëngues dhe mbrojtës për viktimat e të gjitha formave të dhunës dhe të sigurojnë sanksionimin e shkeljeve të urdhrave.⁶⁸ Dhënia e urdhrave nuk duhet të jetë një barrë administrative ose financiare për viktimën dhe nuk varet nga fakti a po zhvillohet procedura penale ndaj kryesit të aktit të dhunës.

3.9 Emigrimi dhe azili

Konventa ndalon diskriminimin në bazë të statusit të emigrantëve ose refugjatëve kur është fjala për zbatimin e dispozitave të saj. Ajo e pranon faktin që këto dy grupe janë veçanërisht të

⁶⁶ Po aty, neni 45.

⁶⁷ Po aty, neni 52.

⁶⁸ Po aty, neni 53.

ndjeshme ndaj dhunës me bazë gjinore, dhe kërkon që të ndërmerren masa për të parandaluar dhunën e tillë dhe për të mbështetur viktimat, duke zbatuar procedurat e ndjeshme gjinore. Një rëndësi e veçantë i është kushtuar obligimit të shteteve të njohin dhunën me bazë gjinore ndaj grave si një formë persekutimi, i cili do të merret parasysh kur vendoset sipas kërkesës për azil. Për më tepër, Konventa përcakton detyrimin për të respektuar parimin e moskthimit, për të siguruar që viktimat e dhunës ndaj grave, pavarësisht nga statusi ose vendbanimi i tyre, nuk do të kthehen në asnjë vend ku jeta e tyre do të ishte në rrezik ose ku ato mund t'i nënshtrohen torturës, apo trajtimit çnjerëzor ose degradues.⁶⁹

3.10 Mekanizmi i monitorimit të Konventës

Mekanizmi monitorues i Konventës së Stambollit⁷⁰ synon vlerësimin e zbatimit të Konventës nga shtetet, dhe përmirësimin e këtij zbatimi. Mekanizmi i monitorimit është i bazuar në dy shtylla. Ai përbëhet nga dy organe të pavarura, por ndërvepruese: Grupi i ekspertëve për masat kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (të ashtuquajtur GREVIO), dhe Komiteti i Palëve, si një trup politik, i cili përbëhet nga përfaqësuesit e shteteve palë.

GREVIO është një organ i pavarur i ekspertëve. Ai shqyrton raportet e shteteve mbi zbatimin e Konventës, dhe mund të marrë informacione nga OJQ-të dhe shoqëria civile, si dhe nga institucionet kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në bazë të të gjitha informacioneve të marra, GREVIO përgatit raportin dhe konkluzionet, të cilat i dërgohen shtetit dhe Komitetit të Palëve. Po ashtu, GREVIO mund të organizojë vizita në vende, për të plotësuar informacione, nëse i konsideron ato të pamjaftueshme, ose për të hetuar situata ku problemet kërkojnë vëmendje të menjëhershme për të parandaluar shkelje të rënda të Konventës. GREVIO mund të miratojë, kur është e përshtatshme, rekomandime të përgjithshme mbi temat dhe konceptet e Konventës.

Komiteti i Palëve ndjek raportet dhe konkluzionet e GREVIO-së dhe miraton rekomandime specifike. Ai është gjithashtu përgjegjës për zgjedhjen e anëtarëve të GREVIO-së.

Risi sipas Konventës së Stambollit, është detyrimi i shteteve për të ftuar parlamentet e tyre për të marrë pjesë në procesin e monitorimit dhe për të shqyrtuar raporte dhe rekomandime të GREVIO-së. Ngjashëm, për herë të parë, Konventa parasheh një rol të rëndësishëm për

⁶⁹ Po aty, nenet 59-61.

⁷⁰ Po aty, nenet 66-70.

Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, e cila shqyrton zbatimin e Konventës në intervale të rregullta.

4. Kuadri ligjor kombëtar

Për një kohë të gjatë, zakonet patriarkale, qëndrimet tradicionale dhe rolet historike gjinore kanë kufizuar të drejtën e grave në Kosovë për të dhënë kontributin e plotë në të gjitha aspekte të jetës shoqërore. Por, Kosova ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të krijuar një kuadër ligjor dhe të politikave, me synim të përmirësimit të pozitës së gruas. Kushtetuta e Kosovës garanton barazinë ndërmjet burrave dhe grave si një e drejtë themelore dhe siguron mundësi të barabarta për pjesëmarrje të grave dhe burrave në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat tjera të jetës shoqërore (neni 7). Po ashtu, nuk mungon tërësia e ligjeve dhe mekanizmave institucionale për trajtimin e diskriminimit mbi baza gjinore. Vëmendje të veçante është kushtuar mbrojtjes nga dhuna në familje. Por, ende mungon ndonjë ligj apo strategji gjithëpërfshirëse për të trajtuar të gjitha format e dhunës ndaj grave apo dhunës në baza gjinore.

4.1 Ligji Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore

Ligji Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore trajton çështjet e barazisë gjinore në Kosovë,⁷¹ dhe vendos barazinë ndërmjet gjinive si vlerë themelore të zhvillimit demokratik të shoqërisë kosovare. Ligji garanton mundësi të barabarta dhe trajtim të barabartë të grave dhe burrave, si në sferën publike ashtu edhe private. Sipas nenit 3, paragraf 1.1, barazia gjinore përkufizohet si ushtrim i plotë dhe i barabartë i të drejtave të njeriut të grave dhe të burrave, që nënkupton mospranimin e diskriminimit në bazë gjinore në mundësitë, ndarjen e burimeve apo përfitimeve, si dhe qasjen në shërbime. Përfaqësimi i njëjës gjini, i cili është më i ulët se pesëdhjetë për qind, në çdo organ dhe nivel vendimmarrës në jetën politike dhe publike, konsiderohet si përfaqësimi i pabarabartë.⁷² Ligji për Barazi Gjinore për më tutje, në nenin 4, ndalon diskriminimin gjinor të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Sipas Ligjit, diskriminimi i drejtpërdrejtë gjinor ndodh kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa

⁷¹ Ligji Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore hyri në fuqi në qershor 2015, dhe zëvendësoj ligjin e mëparshëm për barazi gjinore të vitit 2004, për të përafuar atë me standarde ndërkombëtarë. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10923>

⁷² Ligji Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore, neni 3. 1.15.

trajtohet një person i gjinisë tjetër në një situatë të krahasueshme, ndërsa diskriminimi i tërthortë gjinor ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë e paanshme në dukje e vë personin e gjinisë tjetër në pozitë të pabarabartë.

Ligji për Barazi Gjinore për më tej ofron (neni 3. 1.18), një përkufizim të dhunës në baza gjinore, e cila, “nënkupton të gjitha aktet e dhunës që rezultojnë apo kanë të ngjarë të rezultojnë në dëmtim apo vuajtje fizike, seksuale, psikologjike, sociale apo ekonomike në baza gjinore, duke përfshirë kërcënime për akte të tilla, shtrëngim, apo heqje arbitrare të lirisë, qoftë kur kjo ndodh në jetën publike apo private.” Me tej, në nenin 4.2, përcaktohet: “Dhuna në baza gjinore është një formë e diskriminimit e cila seriozisht pengon aftësinë e femrave dhe meshkujve që t’i gëzojnë të drejtat dhe liritë në baza të barabarta dhe është e ndaluar.” Vlen të theksohet që ky definicion kufizohet vetëm në natyrën diskriminuese të dhunës, duke shmangur kategorizimin e dhunës si shkelje e të drejtave të njeriut. Po ashtu, përkufizimi trajton dhunën ndaj të dy gjinive dhe i mungon një qasje e ndjeshme gjinore ndaj dhunës së drejtuar kundër grave.

Për dallim, Konventa e Stambollit e pranon natyrën strukturore të dhunës kundër grave si dhunë gjinore, dhe thekson se gratë dhe vajzat janë më shumë të ekspozuara se sa burrat ndaj rrezikut të dhunës gjinore. Për këtë arsye, Konventa e Stambollit përkufizon dhunën gjinore kundër grave si dhunë që drejtohet kundër një gruaje për faktin se ajo është grua, ose që prek gratë në mënyrë jo proporcionale. Si e tillë, në frymën e Konventës, dhuna është abuzim i të drejtave të njeriut të grave, i cili njëkohësisht paraqet një mekanizëm social për nënshtrimin e grave. Kjo nuk reflektohet në Ligj për Barazi Gjinore, edhe pse ligji përcakton një varg masash dhe mekanizmash për të kujdesur dhe arritur barazinë gjinore.

Në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligj, është hartuar *Programi për Barazinë Gjinore në Kosovë (2008-2013)*, i cili ka zbërthyer më tej integrimin e parimit të barazisë gjinore në ligje, politika dhe shërbime publike.

4.2 Ligji Nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Parimi i mosdiskriminimit është ndër parime themelore të rendit kushtetutës të Kosovës. Ligji Nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi,⁷³ zbaton këtë parim në praktikë, dhe ndalon të gjitha format e diskriminimit në shoqëri kosovare, përfshirë këtu diskriminimin në baza gjinore. Ligji përcakton “një kornizë të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.” (neni 1). Ligji më tutje thekson që “zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës.” Pra, për të jetësuar parimin e trajtimit të barabartë, Ligji parasheh ndalimin e pakufizuar të të gjitha formave të diskriminimit dhe ofron mbrojtje ligjore kundër sjelljeve diskriminuese jo vetëm nga organet publike por edhe nga organizatat private dhe individët. Diskriminimi ndalohet në qasje dhe gëzim e çdo të drejtë të përcaktuar me ligj. Ligji po ashtu përcakton mekanizmat institucional dhe procedurat për mbrojtje nga diskriminimi, ndërsa aktet diskriminuese paraqesin kundërvajtje dhe dënohen me gjobë.⁷⁴

4.3 Ligji Nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje

Ligji Nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje hyri në fuqi në gusht të vitit 2010. Qëllim i Ligjit është parandalimi i dhunës në familje në të gjitha format e saj dhe trajtimi i dhunës me masa të përshtatshme ligjore. Përveç mbrojtjes së viktimave me masa mbrojtëse, Ligji synon të ofron një bazë ligjore për trajtimin e kryesve të dhunës në familje dhe lehtësimin e pasojave.⁷⁵

⁷³ Ligji hyri në fuqi në qershor të vitit 2015, duke shfuqizuar Ligjin nr. 2004/3 kundër diskriminimit. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10924>

⁷⁴ Ligji Nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, neni 23.

⁷⁵ Ligji Nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, neni 1.

Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje numëron në hollësi sjelljet që përbëjnë dhunë në familje, përfshirë akte të dhunës fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike, duke e lënë të hapur mundësinë e përfshirjes së çdo akti tjetër të dhunshëm të kryer brenda familjes. Sipas nenit 2.1.2, dhuna në familje përkufizohet si: “një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bëjnë një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare si këto, por nuk kufizohet në:

- 1.2.1. përdorimin e forcës fizike ose presionin psikik të ushtruar ndaj anëtarit tjetër të familjes;
- 1.2.2. çdo veprim tjetër i një anëtari të familjes që mund të shkaktojë apo kanos, se do të shkaktojë dhembje fizike dhe vuajtje psikike;
- 1.2.3. shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimin e dinjitetit;
- 1.2.4. sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat;
- 1.2.5. ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë;
- 1.2.6. përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përluljes së personit tjetër;
- 1.2.7. marrëdhënia seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimi seksual;
- 1.2.8. kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër;
- 1.2.9. dëmtimi apo shkatërrimi i pasurisë dhe kanosja që ta bëjë këtë;
- 1.2.10. vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike;
- 1.2.11. hyrja apo largimi me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesën e personit tjetër;
- 1.2.12. rrëmbimi.”

E drejta për të gëzuar mbrojtje dhe mbështetje i takon të gjithë personave që janë në marrëdhënie familjare, e cila sipas nenit 2.1.1, përfshin personat që: “janë të fejuar apo ishin të fejuar; janë të martuar apo ishin të martuar; janë në bashkësi jashtëmartesore apo ishin në bashkësi jashtëmartesore; bashkëjetojnë apo kanë bashkëjetuar në ekonomi të përbashkët; përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martesë, adoptimi, krushqie apo janë në lidhje kujdestarie; janë prindër të një fëmije të përbashkët; apo janë palë procedurale në një kontest nga marrëdhëniet familjare.”

Me qëllim të parandalimit dhe mbrojtjes së viktimave nga shfaqja ose rishfaqja e akteve të dhunës në familje, Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje përcakton shqiptimin e masave mbrojtëse, të cilat përfshijnë: trajtimin psikosocial (neni 4); ndalimin e afrimit viktimës së dhunës në familje (neni 5); ndalimin e shqetësimit personave të ekspozuar dhunës (neni 6); largimin e kryesit nga banesa, shtëpia, apo hapësira tjetër e banimit (neni 7); shoqërimin e viktimës së dhunës për marrjen e gjësendeve personale (neni 8); trajtimin mjekësor nga varësia prej alkoolit dhe substancave psikotrope (neni 9); marrjen e sendit që është përdorur në kryerjen e veprës të dhunës në familje (neni 10); dhe masat mbrojtëse pasurore (neni 11).

Gjykata themelore është kompetente për të vendosur masa mbrojtëse, dhe mund të shqiptoj një urdhër mbrojtje, ose një urdhër mbrojtje emergjente.⁷⁶ Këto urdhra caktohen nga gjykata në rastet kur dyshohet se kryesi i dhunës në mënyre të pashmangshme rrezikon sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e viktimës.⁷⁷ Jashtë orarit të punës së gjykatave, policia mund të shqiptoj urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente, në rastet e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për viktimës. Urdhri për mbrojtje të përkohshme emergjente skadon në fund të ditës së ardhshme gjatë të cilës punon gjykata.⁷⁸

Kërkesat për cilindo lloj të urdhrin mund të parashtrihen nga viktima, përfaqësuesi i autorizuar i viktimës, mbrojtësi i viktimës, ose në rastet kur viktima është i/e mitur, nga Qendra për Punë Sociale. Kërkesat për urdhër mbrojtje emergjente dhe për urdhër për mbrojtje të përkohshme emergjente, mund gjithashtu të paraqiten nga personi me të cilin viktima ka lidhje familjare, ose nga persona që janë në dijeni të drejtpërdrejtë për vepra të dhunës në familje, apo nga OJQ-të që janë familjarizuar me viktimën, dhe kanë informata të sigurta për dhunën në familje.⁷⁹ Kërkesa duhet të përmbajë një përshkrim të hollësishëm të gjendjes faktike si dhe arsyet për parashtrimin e kërkesës, së bashku me propozimin e masës mbrojtëse. Nëse është e mundur kërkesës i bashkëngjiten provat.⁸⁰ Gjykata vendos për kërkesat për urdhër mbrojtje brenda 15 ditëve pas parashtrimit të kërkesës, ndërsa procedura sipas kërkesës për urdhër mbrojtje emergjente është urgjente dhe gjykata duhet të vendos brenda 24 orëve pas parashtrimit të kërkesës.⁸¹

⁷⁶ Po aty, neni 3.

⁷⁷ Po aty, neni 17. 1.

⁷⁸ Po aty, neni 22.

⁷⁹ Po aty, nenet 13 dhe 22.

⁸⁰ Po aty, neni 14.

⁸¹ Po aty, nenet 15 dhe 16.

Urdhri për mbrojtje shqiptohet për një periudhë kohore e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 12 muaj, dhe mund të vazhdohet për më së shumti 24 muaj. Urdhri për mbrojtje emergjente lëshohet përkohësisht, dhe brenda tetë ditëve prej shqiptimit të tij caktohet dëgjimi për vërtetimin e tij. Urdhri për mbrojtje emergjente skadon në fund të dëgjimit për vërtetim, dhe nëse vërtetohet, gjykata e zëvendëson atë me urdhrin për mbrojtje.⁸² Në urdhrin për mbrojtje dhe urdhrin për mbrojtje emergjente duhet të shënohen masat mbrojtëse të caktuara nga gjykata dhe duhet të ceket që moszbatimi i urdhrit paraqet vepër penale.⁸³ Organ kompetent për ekzekutimin e masave mbrojtëse është Policia e Kosovës.⁸⁴ Policia duhet t'i përgjigjet secilit njoftim për veprat e dhunës në familje, ose për shkeljen të urdhrin për mbrojtje apo të urdhrin për mbrojtje emergjente pa marrë parasysh se kush e bën njoftimin. Po ashtu, nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se është kryer akti i dhunës në familje, policia e ndalon kryesin e supozuar në pajtim me ligjin.⁸⁵

Edhe pse Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është ligj civil, me qëllim kryesor që të sigurojë mbrojtjen e viktimave, dhe jo të parashikojë dënim penal, ai përcakton që shkelja e urdhrin për mbrojtje, apo urdhrin për mbrojtje emergjente, ose urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente, paraqet vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare. Shkelja dënohet me gjobë prej dyqind (200) euro deri në dymijë (2000) Euro, ose me burgim deri në gjashtë muaj.⁸⁶

4.4 Akte nënligjore, procedurat, dhe programe të veprimit

Ligji Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore, dhe hartimin e programit kundër dhunës në familje, për të zbatuar dhe jetësuar dispozitat ligjore. Deri tani, janë miratuar dy akte nënligjore me qëllim të trajtimit të nevojave të kryesve të veprave të dhunës në familje: *Udhëzimi Administrativ nr. 12/2012 për përcaktimin e vendit dhe mënyrës së trajtimit psiko-social të kryesit të dhunës në familje*,⁸⁷ i cili zbatohet ndaj kryerësve të dhunës në familje të cilëve gjykata iu shqipton masën e trajtimit të detyrueshëm të rehabilitimit psikosocial, dhe *Udhëzimi Administrativ nr. 02/2013 për mënyrën e trajtimit të kryesve të dhunës në familje ndaj të cilëve është shqiptuar masa e mbrojtjes e trajtimit të*

⁸² Po aty, neni 18.

⁸³ Po aty, neni 18.

⁸⁴ Po aty, neni 3.

⁸⁵ Po aty, neni 24.

⁸⁶ Po aty, nenet 25 dhe 26.

⁸⁷ Miratuar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës në vitin 2012.

*obligueshëm mjekësor nga varësia e alkoolit dhe substancave psikotropike.*⁸⁸ Aktet nënligjore lejojnë ofrimin e shërbimeve psikosociale dhe shëndetësore nga OJQ-të të licencuara.

Për të konsoliduar bashkëveprimin dhe ndërveprimin ndërmjet akterëve, me qëllim që dhuna në familje të adresohet në mënyre efektive, Qeveria e Kosovës ka hartuar dhe zbatuar *Programin e Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Planin e Veprimit 2011-2014*, i cili ka ndihmuar në krijimin e mekanizmave efikas dhe gjithëpërfshirës për parandalimin e dhunës në familje, mbrojtje dhe rehabilitimin të viktimave.

Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje janë miratuar në vitin 2013, për të krijuar një sistem institucional të koordinuar i cili mundëson reagimin në formë të menjëhershme dhe të vazhdueshme në rastet e dhunës në familje. Procedurat Standarde të Veprimit ofrojnë një përshkrim të detajuar të roleve dhe përgjegjësive për policinë, punëtorët social, avokatët e viktimave duke përfshirë gjithashtu gjykatësit, mësimdhënësit, ofruesit e shërbimeve shëndetësore, prokurorët dhe personelin e strehimores në identifikimin, referimin si dhe asistimin e viktimave të dhunës në familje. OJQ-të janë përfshirë si partnerët mbështetës joqeveritar në ofrimin e shërbimeve.

Kuadri ligjor kombëtar plotësohet më tej me Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Planin e Veprimit 2016 – 2020, që do të shtjellohet më hollësisht në vazhdim.

4.5 Kodi Penal i Republikës së Kosovës

Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr. 04/L-082, i cili hyri në fuqi me 1 janar 2013, nuk ofron një përkufizim të dhunës në familje, por përcakton një numër të veprave penale, që ofrojnë bazë për ndjekje penale, nëse janë të kryera në marrëdhëniet familjare. Ndër të tjera, këto janë: Skllavëria, kushtet e ngjashme me skllavërinë dhe puna e detyruar (neni 169); Vrasja e rende (neni 179); Shtytja në vetëvrasje dhe ndihma në vetëvrasje (neni 183); Ndërprerja e palejuar e shtatzënësisë (neni 184); Lëndimi i lehtë trupor (neni 188); Lëndimi i rëndë trupor (neni 189);

⁸⁸ Miratuar nga Ministria e Shëndetësisë në vitin 2013.

Kanosja (neni 185); Ngacmimi (neni 186); Sulmi (neni 187); Shtërëngimi (neni 195); Privimi i kundërligjshëm i lirisë (neni 196); Cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve (neni 200); Dhunimi (neni 230); Sulmi seksual (neni 232); Degradimi i integritetit seksual (neni 233); Keqpërdorimi seksual i personave me çrregullime ose paaftësi mendore apo emocionale (neni 234); Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet (neni 235); Marrëdhëniet seksuale brenda familjes (neni 243); Mos raportimi i abuzimit të fëmijëve (neni 254); Martesa e detyruar (neni 246); Bashkëjetesa martesore me personin nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet (neni 247); Marrja ose mbajtja e kundërligjshme e fëmijës (neni 249); Keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës (neni 250); Shkelja e detyrimeve familjare (neni 251); Shmangja nga sigurimi i mjeteve të jetesës (neni 252); Shantazhi (neni 341); Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër (neni 344), etj. Kodi Penal në nenin 120 paragrafi 37, përkufizon ‘viktimë e ndjeshme’ e cila nënkupton “fëmijë, person me aftësi të kufizuara fizike apo mendore, person me aftësi të zvogëluar, grua shtatzënë ose partner familjar.” Në raste kur vepra penale kryhet ndaj viktimës së ndjeshme, kryesi dënohet me dënime më të larta. Gjithashtu, sipas nenit 74, paragrafi 2.12, me rastin e caktimit të dënimit, gjykata cilëson si rrethana rënduese nëse vepra penale është kryer ndaj një personi për shkak të gjinisë apo orientimit seksual.

Duhet të theksohet që Konventa e Stambollit u kërkon shteteve të ndërmarrin masat e nevojshme ligjore për të siguruar hetim dhe ndjekje penale efektive për veprat penale të dhunës kundër grave dhe dhunës në familje. Për këtë arsye, Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Planin e Veprimit 2016 – 2020 rekomandon amendamentimin e Kodit Penal me qëllim të specifikimit të dhunës në familje si vepër penale në Kodin Penal.

4.6 Strategjia Kombëtare e Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i saj i Veprimit 2016–2020

Strategjia Kombëtare e Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i saj i Veprimit 2016–2020, është hartuar me qëllim që të shërbejë si një udhëzues drejt një shoqërie pa dhunë, e cila ka për bazë një familje të shëndoshë që mbron, respekton dhe trajton me përparësi dhe pa asnjë dallim, nevojat e çdo anëtari të saj. Vizioni i Strategjisë është: *“Një shoqëri që u siguron të gjithë shtetasve të saj, të rritur dhe fëmijë, të jetojnë pa frikën apo kërcënimin e dhunës në familje, që mbron viktimat, vendos kryesit përpara përgjegjësisë dhe zvogëlon tolerancën e publikut ndaj veprimeve të dhunshme”*.

Strategjia Kombëtare e Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje thekson faktin që, pavarësisht ndryshimeve pozitive dhe përparimit të arritur, dhuna ndaj grave ende ekziston në shoqërinë kosovare. Për më tej, theksohet që në Kosovë, dhuna në familje vazhdon të jetë forma më e përhapura e dhunës që prek kryesisht gratë dhe fëmijët, për shkak të gjendjes socio-ekonomike të tyre, që i bën të jenë më të varur nga anëtarët tjerë të familjes. Për të trajtuar dhunën në familje, synimet e Planit Kombëtar të Veprimit janë që deri në vitin 2020, Qeveria e Kosovës së bashku me institucionet dhe palët përgjegjëse: të trajtojnë me prioritet dhe efektivitet të gjitha rastet e dhunës në familje; të sigurojnë qasje në shërbime të integruara cilësore; të garantojnë drejtësi dhe përgjegjësi për personat që pësojnë dhunë; të sigurojnë rehabilitim dhe riintegrim të viktimave të dhunës; dhe të rrisin vetëdijesimin e shoqërisë për ta ndaluar dhunën në familje. Zbatimi i Strategjisë ka për qëllim të konsolidojë bashkëveprimin mes palëve pjesëmarrëse duke: fuqizuar funksionalizimin e mekanizmave ekzistues dhe duke themeluar mekanizma të rinj për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje; duke koordinuar veprime dhe siguruar qëndrueshmëri të rregullt të vijave buxhetore në mbështetje të veprimeve për mbrojtje nga dhuna në familje në nivel qendror dhe lokal; duke zbatuar masa për ndëshkimin dhe rehabilitimin e kryesve të dhunës; si dhe duke organizuar fushata të vetëdijesimit kundër dhunës në familje.

4.6.1 Objektivat strategjike dhe specifike

Strategjia Kombëtare e Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është konceptuar rreth katër objektivave strategjike: 1. Parandalimi dhe vetëdijesimi; 2. Mbrojtja dhe koordinimi; 3. Legjislacioni, hetimi dhe procedimi; dhe 4. Rehabilitimi dhe riintegrimi. Në kuadër të

objektivave strategjike, deri në vitin 2020, Strategjia Kombëtare synon në përmbushjen e qëllimeve specifike, si në vijim:

Objektivi strategjik 1: Parandalimi dhe vetëdijesimi

1. Zvogëlimi i qëndrimeve paragjyquese dhe sjelljeve që e mbështesin dhunën në familje, nëpërmjet informimit, edukimit, arsimimit si dhe vetëdijesimit të vazhdueshëm. (Objektivat specifike: 1.1. Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve që ofrojnë shërbimet për parandalimin e dhunës në familje; 1.2. Inkurajimi i viktimave për lajmërimin e rasteve të dhunës në familje; 1.3. Rritja e vetëdijesimit të shoqërisë për të mos toleruar ushtrimin e dhunës në familje.)

Objektivi strategjik 2: Mbrojtja dhe koordinimi

2. Sigurimi i mekanizmave gjithëpërfshirëse dhe efikase për reagim të shpejtë ndaj rasteve të dhunës në familje, si dhe bashkëpunimi ndërinstitucional në nivel qendror dhe lokal. (Objektivat specifike: 2.1. Avancimi i politikave gjithëpërfshirëse në kuadër të mbrojtjes së viktimave; 2.2. Përmirësimi i funksionalizimit të mekanizmave koordinues institucionale ekzistues në nivel lokal si dhe ngritja e tyre në komunat ku mungojnë. 2.3. Përmirësimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet nivelit qendror, lokal dhe organizatave të shoqërisë civile për mbrojtjen e viktimave)

Objektivi strategjik 3: Legjislacioni, hetimi dhe procedimi;

3. Përmirësimi i infrastrukturës ligjore dhe ngritja e efikasitetit të trajtimit të rasteve të dhunës në familje, me fokus në nevojat e viktimës si dhe ndëshkimi adekuat i kryesit të dhunës. (Objektivat specifike: 3.1. Përmirësimi i infrastrukturës ligjore për trajtimin efikas të rasteve të dhunës në familje. 3.2. Specializimi i hetuesve policor, punëtorëve social, mbrojtësve të viktimave, prokurorëve dhe gjyqtarëve, për procedimin me urgjencë dhe kujdes të shtuar të rasteve të dhunës në familje. 3.3. Qartësimi i roleve, detyrave dhe përgjegjësisë të secilit institucion në ofrimin e shërbimeve adekuate për rastet e dhunës në familje.)

Objektivi strategjik 4. Rehabilitimi dhe riintegrimi

4. Qasja në shërbime të reja dhe ekzistuese, efikase dhe të qëndrueshme, për rehabilitimin dhe riintegrimin afatgjatë të viktimave dhe të kryesve të dhunës në familje, në tërë territorin e Kosovës. (Objektivat specifike: 4.1. Ngritja e shërbimeve për rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje. 4.2. Ndarja e fondeve për shërbimet riintegruese afatgjata për viktimat e dhunës në familje. 4.3. Përdorimi i politikave të integruara për përmirësimin e shërbimeve

rehabilituese dhe riintegruese për viktimat. 4.4. Themelimi i institucioneve rehabilituese dhe këshillimoreve me programe të obligueshme për kryesit e dhunës në familje.)

4.6.2 Institucionet dhe mekanizmat ekzistues në përgjigje të dhunës në familje

Strategjia Kombëtare e Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje numëron institucionet kryesore që veprojnë në përmbushje të kuadrit ligjor dhe për ndihmën e viktimave të dhunës në familje si në vijim:

- **Koordinatori Nacional kundër Dhunës në Familje** – është përzgjedhur të jetë Zëvendësministri i Drejtësisë, me mandat të mbikëqyrë zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe zbatimin e aktiviteteve të Planit Kombëtar të Veprimit dhe të koordinojë punën e Grupit Koordinues Ndërmintor kundër Dhunës në Familje.
- **Policia e Kosovës** – është një nga institucionet kryesore për mbrojtjen nga dhuna. Policia bën hetimin dhe ndjekjen penale për krimet që kryhen në familje në përputhshmëri me Kodin Penal të Kosovës, dhe zbaton urdhrat e mbrojtjes sipas Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Policia ka për detyrë t'i përgjigjet çdo lloj të kërcënimi apo akti të dhunës, ta shoqërojë viktimën dhe të arrestojë menjëherë të dyshuarit për vepra penale. Policia e Kosovës ka themeluar Njësitë e Hetimeve për Dhunë në Familje në çdo komunë.
- **Prokuroria** – Prokurorët janë të detyruar të marrin veprime sapo të njoftohen për ndonjë rast të dhunës në familje, duke përfshirë shkelje të urdhrave, për të përcaktuar nëse ka fakte të mjaftueshme për ndjekjen penale. Prokuroria dhe policia bashkëpunojnë në rastet e dhunës në familje, ndërsa prokuroria duhet të mbikëqyrë punën e policisë për të siguruar mbledhjen cilësore të provave. Pas përfundimit të hetimeve prokuroria duhet të ngrejë aktakuzë ndaj kryesit e dhunës, ose të hedhë poshtë kallëzimin penal. Në rastin e fëmijëve viktimë, prokurori ka për detyrë të zhvillojë ndjekjen penale në mënyrën që i shërben interesave më të mira të fëmijës.
- **Gjykatat themelore** – kanë rolin kryesor për sigurimin e trajtimit të ligjshëm dhe të drejtë të të gjitha palëve në rastet e dhunës në familje. Detyra e tyre përfshinë shqyrtimin e kërkesave për urdhra të mbrojtjes, në procedurë civile, sipas Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Në procedurat penale gjykatat kanë autoritet të dënojnë kryesit e veprave penale që ndërlidhen me dhunë në familje, si dhe personat të cilët kanë shkelur urdhrat e mbrojtjes. Strategjia rekomandon që gjykatat të ndryshojnë politikën ndëshkimore ndaj kryesit të veprave të dhunës në familje.

- **Zyra për Mbrojtje dhe Ndhmë Viktimave (ZMNV)** – gjendet në Zyrën e Prokurorit të Shtetit të Kosovës, me përgjegjësitë që të mbron të drejtat e viktimave. Pas reagimit të policisë mbrojtësi i viktimave takohet me viktimën dhe e informon për shërbimet që ofrohen nga shteti. ZMNV-ja ka një numër telefonik publik falas për personat që duan ta raportojnë dhunën në familje. Strategjia rekomandon që t’i lihet më shumë hapësire funksionimit të linjës.
- **Zyrat për Ndhmë Juridike Falas** – Në bazë të Ligjt për Ndhmë Juridike Falas të miratuar në vitin 2012, viktimat e dhunës në familje kanë të drejtë të kërkojnë ndhmë juridike falas (neni 31). Në mungesë të dokumentacionit për kategorinë e viktimave të dhunës merret deklarata me shkrim e Mbrojtësit të Viktimës.
- **Institucioni i Avokatit të Popullit** – është përgjegjës për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në rast se ndonjë nga institucionet e Kosovës gjatë trajtimit të rastit të dhunës në familje e keqtrajton viktimën, viktimat ka të drejtë ta raportojë rastin tek Avokati i Popullit.
- **Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK)** – është përgjegjës për risocializimin e të burgosurve duke respektuar të drejtat e tyre në pajtim me ligj. ShKK-ja duhet të krijojë kushte për të mundësuar që të burgosurit të marrin shërbime të duhura, sidomos nëse personi ka probleme që lidhen me abuzim me alkoolin dhe/ose drogën.
- **Shërbimi Sprovues** – është organ i administratës shtetërore që gjendet në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, me përgjegjësi për organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative dhe të riintegrit shoqëror të personave të dënuar dhe të personave të liruar me kusht.
- **Qendrat për Punë Sociale** – janë institucione publike në nivelin komunal të cilat ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, mbrojtje dhe ndhmë financiare për rastet në nevojë sociale, duke përfshirë edhe personat të cilët kanë përjetuar dhunë në familje. Qendrat gjithashtu kanë kompetenca si organ kujdestarie për të miturit.
- **OJQ-të dhe strehimoret** – ofrojnë strehim, rehabilitim dhe riintegrim për viktimat e dhunës në familje. Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare parasheh që çdo OJQ që ofron shërbime sociale duhet të regjistrohet pranë organit përkatës dhe të licencohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- **Institucionet arsimore** – janë të obliguara të kenë pedagogë dhe psikologë në institucione në mënyrë që të ofrojnë ndhmë fëmijëve që kanë nevojë për përkrahje. Institucionet e arsimit kanë përgjegjësi ligjore ta raportojnë abuzimin me fëmijët.

- **Institucionet shëndetësore** – ofrojnë shërbime shëndetësore viktimave të dhunës në familje duke i zbatuar Procedurat Standarde të Veprimit si dhe duke respektuar etikën mjekësore dhe konfidencialitetin. Ministria e Shëndetësisë ka obligim të sigurojë infrastrukturën e nevojshme për zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.
- **Zyrat e Punësimit dhe Qendrat e Aftësisit Profesional** – Zyrat e Punësimit kanë për detyrë regjistrimin e të papunëve, dhe këshillimin për punësim, ndërsa Qendrat e Aftësisit Profesional ofrojnë trajnim profesional për personat të referuar nga Zyrat e Punësimit. Këto institucione, ofrojnë shërbime të punësimit dhe kualifikime profesionale për viktimat e dhunës në familje.
- **Institucionet komunale dhe mekanizmi koordinues për mbrojtjen nga dhuna në familje** – Komunat janë përgjegjëse për financimin e ofruesve të shërbimeve siç janë strehimoret. Disa komuna të mbështetura nga organizatat ndërkombëtare, kanë krijuar apo janë në proces të krijimit të mekanizmave koordinues që përfshijnë të gjitha palët e interesuara, në mënyrë që të përmirësohet edhe më shumë ndihma që u ofrohet viktimave të dhunës.

5. Rekomandime

Dhuna ndaj grave dhe vajzave, duke përfshirë edhe dhunën në familje, është një prej formave më të rënda të shkeljeve të të drejtave të njeriut, e cila ndikon në gjitha segmentet e shoqërisë.

Ndryshimet në sistemin shoqëror, politik dhe ekonomik shoqërohen nga një reformë ligjore që synon krijimin e sistemit ligjor në përputhje me kërkesat e pluralizmit demokratik, sundimit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Ligjet e Kosovës duhet të jenë në pajtueshmëri me standardet, traktatet dhe obligimet ndërkombëtare. Ligjet që trajtojnë çështjet e dhunës kundër grave kanë disa veçori specifike, për shkak të objektivit dhe fushëveprimit të posaçëm. Në vijim janë disa rekomandime që duhet të konsiderohen në legjislacion për të parandaluar, trajtuar dhe ndëshkuar të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave.

- Qasja gjithëpërfshirëse e cila është e bazuar në të drejtat e njeriut është parimi themelor në të cilin duhet bazuar legjislacioni për të siguruar një përgjigje efektive dhe të koordinuar kundër dhunës ndaj grave. Sipas ligjit ndërkombëtar, shtetet kanë detyrime të qarta për të miratuar, zbatuar dhe monitoruar legjislacionin që trajton të gjitha format e dhunës ndaj grave, gjithmonë duke mbrojtur të drejtat e njeriut.

- Legjislacioni duhet të pranoj se dhuna ndaj grave është një formë e diskriminimit të bazuar në gjini dhe një manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit mes burrave dhe grave. Dhuna ndaj grave duhet të njihet si një nga mekanizmat kryesorë social përmes të cilit gratë vihen në pozitë të varësisë në raport me burrat. Për më tepër, ligjet duhet të njohin që dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje janë forma të shkeljes së të drejtave të njeriut.
- Legjislacioni duhet të përkufizoj diskriminimin ndaj grave si çdo dallim, përjashtim ose kufizim që behët mbi bazën e gjinisë e që ka për qëllim ose për pasojë të pengoj, dëmtoj ose të shfuqizoj njohjen, gëzimin apo ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga gjendja e tyre martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, sociale, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër.
- Legjislacioni duhet të siguroj që të gjitha drejtat e parapara me ligj sigurohen pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjine kombëtare ose sociale, përkatësie në një pakicë kombëtare, pasurie, lindjeje, orientimi seksual, identiteti gjinor, moshe, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar, statusi civil, statusi emigranti ose refugjati ose statusi tjetër.
- Për më tepër, legjislacioni duhet të siguroj që kultura, zakoni, feja ose tradita nuk mund të konsiderohen justifikime për akte dhune. Kjo në veçanti nënkupton pretendime që viktima ka shkelur normat ose zakonet kulturore, fetare, sociale ose tradicionale të sjelljes së duhur.
- Legjislacioni duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe multidisiplinar, duke inkriminuar të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, dhe duhet të përfshij çështjet e parandalimit të dhunës dhe mbrojtjes, fuqizimit dhe mbështetjes së viktimave, si dhe ndëshkimin dhe vënien e kryesve të dhunës përpara përgjegjësisë dhe trajtimin e kryesve të dhunës përmes programeve të obligueshme rehabilituese.
- Ligjet duhet të hartohen me një qasje të ndjeshme gjinore, e cila e bën legjislacionin të ndjeshëm ndaj gjinisë, e jo të verbër. Ndjeshmëria gjinore njeh dallimet midis grave dhe burrave, si dhe nevojat specifike të tyre. Qasja e ndjeshme gjinore mbi dhunën e

bazuar në gjini dhe dhunën ndaj grave pranon se përvojat e grave dhe burrave ndryshojnë dhe që gratë kanë nevoja specifike për mbrojtje dhe mbështetje.

- Për të qenë plotësisht efektiv, miratimi i legjislacionit që trajton çështjet e dhunës ndaj grave duhet të shoqërohet me një rishikim dhe ndryshim, sipas nevojës, të të gjitha ligjeve tjera përkatëse për të siguruar që të drejtat e grave dhe eliminimi i dhunës ndaj grave janë të inkorporuara sistematikisht në të gjitha dispozitat ligjore. Këtu përfshihen, në veçanti, ligjet familjare dhe dispozitat që kanë të bëjnë me shkurorëzimin dhe kujdestarinë e fëmijëve, ligjet pronësore, ligjet që rregullojnë çështjet sociale dhe të drejtat e punës.
- Ligjet duhet të kërkojnë që strukturat përkatëse ekzekutive, në bashkëpunim me policinë, prokurorët, gjyqtarët, sektorin e shëndetësisë dhe sektorin e arsimit, të zhvillojnë rregullore, protokolle, udhëzime, direktiva dhe standarde, për zbatimin e legjislacionit në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe më kohë.
- Legjislacioni ka më shumë gjasa të zbatohet në mënyrë efektive kur shoqërohet nga një kuadër gjithëpërfshirës politikash që përfshijnë një plan ose strategji kombëtare të veprimit. Shtetet duhen të sigurojnë përfshirjen e të gjitha masave ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në një katalog të vetëm të politikave dhe të ofrojnë një përgjigje të përbashkët ndaj dhunës. Strategjia Kombëtare e Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i saj i Veprimit duhet të përdoren si kornizë për zbatimin gjithëpërfshirës dhe të koordinuar të legjislacionit kundër dhunës në familje në Kosovë. Por, rekomandohet të hartohet një strategji gjithëpërfshirëse me qëllim të parandalimit dhe luftimit të të gjitha formave të dhunës ndaj grave.
- Legjislacioni mbi dhunën ndaj grave gjithnjë e më shumë përmban dispozita që kërkojnë shpërndarje buxhetore për zbatimin e tij. Kjo nënkupton krijimin e një obligimi të përgjithshëm për Qeverinë për të siguruar buxhet të përshtatshëm për zbatimin e masave, dhe kërkesën për ndarjen e fondeve për aktivitete të veçanta, si dhe alokimin e fondeve specifike për OJQ për aktivitetet që ndërliken me zbatimin e ligjit.

- Trajnimi i rregullt dhe i institucionalizuar për ndjeshmërinë gjinore dhe ngritja e kapaciteteve mbi dhunën ndaj grave për zyrtarë publik duhet të parashihen në legjislacion. Po ashtu, legjislacioni duhet të mandatoj trajnime të veçanta për zyrtarët publik përkatës kur legjislacioni i ri është miratuar, për të siguruar që ata janë të vetëdijshëm dhe kompetent për të zbatuar detyrat e reja të tyre. Një trajnim i tillë dhe ndërtimi i kapaciteteve duhet të zhvillohen dhe të kryhen në konsultim të ngushtë me OJQ-të që janë aktive në luftimin e dhunës ndaj grave.
- Njësitë e specializuara të policisë, prokurorisë dhe gjyqtarët e specializuar për dhunën ndaj grave do të mundësojnë ofrimin e një përgjigjeje efikase dhe më të ndjeshme gjinore në rastet e dhunës ndaj grave. Krijimi i njësive të specializuara lehtëson zhvillimin e ekspertizës, ndërsa njësitë e specializuara janë dëshmuar si më cilësore, më të përgjegjshme dhe më efektive në trajtimin e dhunës ndaj grave.
- Monitorimi i kujdesshëm dhe i rregullt është kritik për të siguruar që legjislacioni është zbatuar në mënyrë efektive dhe pa efekte negative të paparashikuara. Zbatimi i legjislacionit duhet të mbikëqyret nga një mekanizëm i veçantë dhe shumë-sektorial, që përfshinë OJQ-të, dhe i cili raporton rregullisht në Parlament. Monitorimi duhet të vlerëson suksesin e programeve dhe masave për të parandaluar dhe adresuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, duke identifikuar fushat e ndërhyrjes, në veçanti fushat që kanë nevojë për reformë ligjore.
- Monitorimi duhet të shoqërohet me të dhënat statistikore që mblidhen në intervale të rregullta mbi frekuencën e të gjitha formave të dhunës ndaj grave, dhe mbi shkaqet dhe pasojat e dhunës, për të vlerësuar efektivitetin e masave për të parandaluar, trajtuar dhe ndëshkuar dhunën ndaj grave. Të dhënat e tilla statistikore duhet të ndahen sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, nivelit arsimor dhe karakteristikave tjera përkatëse.
- Legjislacioni duhet të ofroj përkufizimin e dhunës ndaj grave, në pajtim me Konventën e Stambollit. Dhuna ndaj grave duhet të kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi ndaj grave, që nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, pavarësisht nëse këto ndodhin në jetën publike ose private.

- Legjislacioni duhet të përfshij dhunën ndaj grave të kryer nga aktorë të veçantë dhe në kontekste të veçanta. Dhuna ndaj grave duhet kuptuar si dhunë e cila përfshinë dhunën fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike që ndodh brenda familjes, duke përfshirë edhe rrahjen, abuzimin seksual të fëmijëve femra në mjedisin familjar, përdhunimin martesor, gjymtimin gjenital të grave dhe vajzave si dhe praktika tjera tradicionale të dëmshme për gruan; dhunën fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike që ndodh brenda komunitetit të përgjithshëm, duke përfshirë përdhunimin, abuzimin seksual, ngacmimin seksual dhe frikësimin në punë, në institucionet arsimore dhe kudo, trafikimin e grave dhe prostitucionin e detyruar; dhe dhunën fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike të kryer ose të aprovuar nga shteti, kudo që ndodh. Aktorët shtetërorë duhet të përmbahen nga përfshirja në aktet e dhunës ndaj grave, dhe shtetet duhet të marrin masa afirmative për të parandaluar dhe dënuar dhunën e kryer nga aktorët publikë dhe privatë dhe për të krijuar rrjete mbështetëse për t'u kujdesur për viktimat e dhunës së bazuar në gjini.
- Legjislacioni duhet të sqarojë, në pajtim me Konventën e Stambollit, që dhuna gjinore ndaj grave nënkupton dhunën që drejtohet kundër një gruaje për faktin se ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë disproporcionale.
- Legjislacioni duhet të ofroj një përkufizim gjithëpërfshirës të dhunës në familje, përfshirë dhunën fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike. Në këtë aspekt, dhuna në familje nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish-bashkëshortëve ose ish-partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtin vendbanim me viktimën.
- Legjislacioni duhet, në pajtim me kërkesat e nenit 49 të Konventës së Stambollit, të inkriminoj dhunën ndaj grave. Në veçanti dhuna në familje, duke përfshirë dhunën fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike duhet të konsiderohet si vepër penale dhe të dënohet sipas ligjit. Në këtë drejtim rekomandohet ndryshimi i Kodit Penal të Kosovës ku dhuna në familje të përcaktohet si vepër penale, dhe të dënohet me sanksione efektive, proporcionale dhe bindëse.

- Legjislacioni duhet, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Konventës së Stambollit, në mënyrë eksplicite të ndaloj proceset e detyrueshme alternative të zgjidhjes së konflikteve, duke përfshirë ndërmjetësimin dhe pajtimin, në lidhje me të gjitha format e dhunës ndaj grave. Kjo duhet të reflektohet në ligje të Kosovës, sidomos në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, si dhe në Ligjin për Procedurën Kontestimore.
- Përkufizimi i dhunës seksuale është i nevojshëm për të mbrojtur gratë dhe vajzat nga dhuna e bazuar në gjini, në veçanti nga dhunimi dhe çdo lloj i abuzimit seksual. Në mënyrë të veçantë duhet të inkriminohet sulmi seksual brenda marrëdhënies intime, duke përfshirë përdhunimin martesor. Kjo do të bëhet me sigurimin e zbatimit të dispozitave ligjore pavarësisht nga natyra e marrëdhënies ndërmjet kryesit dhe viktimës, duke theksuar se marrëdhënia martesore nuk mund të përbëjë mbrojtje kundër një akuze për sulm seksual. Rekomandohet që dhunimi martesor të përfshihet në mënyrë eksplicite në nenin 230 të Kodit Penal të Kosovës.
- Legjislacioni duhet të përkufizon ngacmimin seksual, i cili sipas Konventës së Stambollit është çdo formë sjelljeje e padëshiruar verbale, jo verbale ose fizike e një natyre seksuale, me qëllim ose efekt të shkeljes së dinjitetit të një personi, veçanërisht kur krijohet një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues. Rekomandohet inkriminimi i ngacmimit seksual dhe përfshirja e kësaj veprë si veprë penale në Kodin Penal të Kosovës.
- Legjislacioni duhet t'i jap përparësi parandalimit të dhunës ndaj grave dhe duhet të përfshij dispozita mbi masat për të parandaluar dhunën ndaj grave, duke përfshirë aktivitete ndërgjegjësimi lidhur me të drejtat e njeriut të grave, barazinë gjinore dhe të drejtën e grave të jenë të lira nga dhuna; hartimin e kurrikulave arsimore për të modifikuar modelet diskriminuese sociale dhe kulturore të sjelljes, si dhe stereotipat diskriminues gjinor.
- Legjislacioni i cili rregullon fushën e arsimit duhet të parasheh, në të gjitha nivelet e shkollimit, nga niveli parashkollor deri në terciar, promovimin e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave dhe vajzave, dhe në veçanti, njohjen e të drejtës së grave dhe vajzave të jenë të lira nga dhuna. Një arsim i tillë duhet të jetë i ndjeshëm ndaj çështjeve gjinore

dhe të përfshij informata të përshtatshme lidhur me ligjet ekzistuese që mbrojnë të drejtat e grave dhe që adresojnë dhunën ndaj grave. Kurrikulat përkatëse duhet të zhvillohen në konsultim me shoqërinë civile.

- Legjislacioni duhet të inkurajoj sensibilizimin e mediave dhe trajnimin e gazetarëve lidhur me dhunën ndaj grave, duke pranuar rolin e mediave në formimin e perceptimeve shoqërore dhe përkufizimin e sjelljeve dhe qëndrimeve të pranueshme. Trajnimi i gazetarëve mbi të drejtat e grave dhe mbi shkaqet rrënjësore të dhunës ndaj grave ndikon në mënyrën e raportimit të dhunës dhe në qëndrimet shoqërore.
- Legjislacioni duhet të parashikoj mbështetjen qeveritare për ngritjen e vetëdijes publike për dhunën ndaj grave, duke përfshirë fushata të përgjithshme që sensibilizojnë popullatën mbi dhunën ndaj grave si një manifestim i pabarazisë dhe si shkelje e të drejtave të njeriut të grave; dhe fushata specifike për të rritur njohjen e ligjeve të miratuara që adresojnë dhunën ndaj grave. Fushatat publike të ngritjes së vetëdijes janë kritike për të përcjellë mesazhin e tolerancës zero ndaj dhunës ndaj grave, dhe janë një mjet i rëndësishëm për informimin e viktimave për të drejtat e tyre dhe mjetet juridike në dispozicion. Fushatat ndërgjegjësimi duhet të organizohen në bashkëpunim me OJQ-të.
- Legjislacioni duhet të parashikoj obligimin e shtetit për të kontribuar në krijimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe të integruara mbështetëse për të ndihmuar të mbijetuarit e dhunës. Këto shërbime duhet të përfshijnë: një linjë telefonike kombëtare ku të gjithë të mbijetuarit e dhunës mund të marrin ndihmë përmes telefonit gjatë gjithë kohës dhe pa pagesë; një strehimore për çdo 10,000 banorë; një qendër për këshillimin e grave për çdo 50,000 gra, që ofron mbështetje, këshilla dhe përkrahje për viktimat të dhunës, duke përfshirë edhe ndihmën ligjore; si dhe shërbime të specializuara për grupe të caktuara siç janë gratë imigrante apo viktimat e trafikimit. Të gjitha shërbimet për gratë që pësuan dhunën duhet të sigurojnë përkrahje adekuate për fëmijët e tyre. Vendndodhja e këtyre shërbimeve duhet të lejoj qasje të drejtë në shërbimet, sidomos nga popullata rurale, dhe duhet të sigurohet që janë arritshme nga pikëpamja fizike dhe gjeografike për grupet e cënueshme të grave.

- Legjislacioni duhet të siguroj ofrimin e ndihmës financiare efektive dhe me kohë për të mbijetuarit e dhunës, në mënyrë që të përmbushen nevojat e tyre. Sidomos ligjet që rregullojnë të drejta të ndryshme të punësimit dhe të sigurimeve shoqërore dhe të benefiteve sociale, duhet të përfshijnë dispozita për mbështetje financiare të viktimave të dhunës. Të mbijetuarat e dhunës ndaj grave kanë kosto financiare afatgjata që lidhen me lëndimet dhe vuajtjet e tyre, produktivitetin e reduktuar dhe mundësitë e kufizuara të punësimit.
- Legjislacioni duhet të përcaktoj masat e nevojshme për të krijuar dhe mbështetur programe që synojnë edukimin e ushtruesve të dhunës në familje dhe ushtruesve të krimeve me motiv seksual, që të përdorin një sjellje jo të dhunshme në marrëdhëniet ndërpersonale, me synim parandalimin e dhunës së mëtejshme dhe ndryshimin e modeleve të dhunshme të sjelljes. Programet duhet të inkurajojnë kryerësit që të marrin përgjegjësinë për veprimet e tyre dhe t'i shqyrtojnë qëndrimet e tyre, me qëllim që të riedukohen dhe dekurajohen nga përsëritja e veprës. Dizajnimi i këtyre programeve duhet të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet mbështetëse të viktimave.
- Legjislacioni duhet të siguroj procedurat të përshpejtuara dhe me kohe në rastet e dhunës ndaj grave. Ligjet duhen të parashikojnë që zyrtarët e policisë t'i përgjigjen menjëherë çdo kërkesë për ndihmë dhe mbrojtje në rastet e dhunës ndaj grave, edhe kur personi që raporton dhunën nuk është viktimë; të japin përparësi thirrjeve për rastet e dhunës ndaj grave; të bëjnë një vlerësim të koordinuar të rrezikut në vendin e ngjarjes dhe intervistojnë palët dhe dëshmitarët në dhoma të veçanta për të siguruar konfidencialitetin dhe mundësi për të folur lirshëm; të këshillojnë viktimën për të drejtat e saj dhe në rast nevojë, të sigurojnë trajtimin mjekësor të viktimës, ose të afërmit e saj. Po ashtu, policia duhet t'i zbatoj politikat e detyrueshme të arrestimit nëse ekzistojnë bazat e arsyeshme për të besuar se ka ndodhur një krim.
- Legjislacioni duhet të siguroj ndjekjen penale sipas detyrës zyrtare për të gjitha veprat e dhunës ndaj grave, dhe duhet të përcaktoj detyrat e prokurorisë si organ kryesor përgjegjës për ndjekjen penale. Prokurorët duhet të sigurojnë që viktimat, në të gjitha fazat e procedurës, janë menjëherë dhe në mënyrë adekuate të informuara në një gjuhë që e kuptojnë, për të drejtat e tyre, për detajet e procedurave përkatëse ligjore; shërbimet

e disponueshme, mekanizmat mbështetës dhe masat mbrojtëse; dhe për mundësitë për marrjen e kompensimit në procedura ligjore.

- Legjislacioni duhet të siguroj që viktimat kanë të drejtë në ndihmën juridike falas, për të siguruar qasjen e tyre në drejtësi dhe për të shmangur viktimizimin dytësor. Ndihma juridike, duke përfshirë këshilla të pavarura ligjore dhe përfaqësim të viktimës, janë komponentët kritike të qasjes në sistemin e drejtësisë, për të mundësuar kuptimin e sistemit ligjor dhe përdorimin e mjeteve juridike në të cilat viktimat kanë të drejtë. Nëse është e nevojshme, viktimës duhet t'i sigurohet asistenca e një përkthyesi të kualifikuar dhe përkthimi i dokumenteve ligjore.
- Legjislacioni duhet të garantoj të drejtat specifike të viktimës gjatë procesit gjyqësor, duke përfshirë të drejtën e viktimës për të paraqitur dëshmi me mjete alternative, siç janë deklaratat nën betim. Kur paraqitet në gjykatë, viktimës duhet t'i mundësohet dhënia e dëshmisë në mënyrë që nuk kërkon përballimin me të pandehurin, duke përfshirë përdorimin e kamerës dhe video lidhjet. Viktimës duhet t'i sigurohet të dëshmon vetëm sa herë që është e nevojshme, dhe të ketë të drejtë të kërkoj seanca jopublike.
- Legjislacioni duhet të siguroj që urdhrat e mbrojtjes janë në dispozicion të viktimave të të gjitha formave të dhunës ndaj grave. Lëshimi i urdhrave të mbrojtjes nuk duhet të ndërlidhet me faktin a po zhvillohet procedura penale ndaj kryesit të dhunës, ose ndonjë procedurë tjetër si p.sh. procedura e shkurorëzimit. Urdhrat për mbrojtje lëshohen përveç masave tjera, dhe kërkesa për urdhër mbrojtje mund të bëhet pavarësisht nga çdo procedurë tjetër, cila nuk ndikon në të drejtën për të kërkuar mbrojtje. Lëshimi i urdhrave për mbrojtje duhet të mundësohet si në procedurë penale, ashtu edhe në civile.
- Urdhrat për mbrojtje duhet të ofrojnë mbrojtje afatgjate. Sipas Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë, urdhri për mbrojtje mund të vazhdohet për më së shumti 24 muaj. Kufizimet aktuale lidhur me zgjatjen e urdhrave për mbrojtje, pa ofrimin e masave alternative, në rastet kur vazhdojnë kushtet, përbëjnë shkelje të të drejtës së viktimave të dhunës në familje në mjet efektiv ligjor dhe mbrojtje efektive nga ana e shtetit kundër akteve të dhunës. Kufizimi kohor prej 24 muajsh për urdhrat për mbrojtje,

i cili është përcaktuar me ligj, do të duhet të hiqet për të ofruar mundësinë e zgjatjes së urdhrimit për mbrojtje deri sa vazhdojnë shkaqet dhe rrethanat për të cilat është vendosur mbrojtja.

- Legjislacioni kosovar duhet të përcaktoj procedura për njohjen e urdhrave mbrojtëse të lëshuar nga autoritetet e vendeve tjera, duke pasur parasysh se një numër i qytetarëve të Kosovës jetojnë dhe veprojnë jashtë vendit, me qëllimin e mbrojtjes efektive të sigurisë, shëndetit dhe mirëqenies së viktimës së dhunës në familje dhe lehtësimin e qasjes së tyre në drejtësi.
- Legjislacioni duhet të inkriminoj shkeljet e urdhrave për mbrojtje. Sipas Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë shkelja e urdhrimit për mbrojtje, apo urdhrimit për mbrojtje emergjente, ose urdhrimit për mbrojtje të përkohshme emergjente, paraqet veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare. Rekomandohet mbikëqyrja e zbatimit të këtyre dispozitave në praktikë, për të siguruar ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme juridike për zbulimin si dhe hetimin dhe ndjekjen me kohë të veprave penale të shkeljes së urdhrave për mbrojtje.
- Legjislacioni duhet të parashikoj dënimet proporcionale me seriozitetin e veprave të kryera të dhunës ndaj grave. Duhet të zhvillohen udhëzime dënimi për të siguruar një qasje të unisuar, dhe qëndrueshmëri në rezultatet e dënimeve. Incidente të përsëritura të dhunës në familje, si dhe shkelje të përsëritura të urdhrave për mbrojtje duhet të mirën parasysh si rrethana rënduese, dhe të dënohen me dënime më të rënda. Gjykatat nuk duhet të vendosen në rastet e dhunës në familje, nëse kjo do të shkaktonte vështirësi financiare për viktimën dhe/ose fëmijët e saj.
- Legjislacioni duhet të siguroj që dënimet në procedura penale mund të urdhërojnë edhe pagesën e kompensimit dhe dëmshpërblimit viktimës nga kryesi i veprës. Ndërsa kompensimi mund të jetë element i ndëshkimit të ushtruesve të dhunës ndaj grave, ai nuk duhet të zëvendësojë dënime të tjera, siç është burgimi. Po ashtu, duhet të lejohet mundësia e padive civile për të kërkuar kompensim. Legjislacioni gjithashtu duhet të parashikon krijimin e një programi për kompensim të sponsorizuar nga qeveria, që i

jep të drejtën të mbijetuarave të dhunës ndaj grave për të aplikuar dhe për të marrë një shumë të drejtë kompensimi.

- Legjislacioni duhet të lejoj mundësi për të mbijetuarat e dhunës ndaj grave për të ushtruar padi civile kundër organeve qeveritare apo individëve dhe subjekteve joqeveritare që nuk kanë ushtruar kujdesin e duhur për të parandaluar, hetuar ose ndëshkuar dhunën; dhe padi në bazë të ligjeve kundër diskriminimit. Padi të kundër palëve të treta ofrojnë një mundësi shtesë për të mbajtur përgjegjës agjencitë qeveritare dhe institucionet tjera për dhunën ndaj grave, dhe gjithashtu mund të paraqesin një burim shtesë të kompensimit monetar për të mbijetuarat.
- Legjislacioni i cili rregullon çështjet familjare duhet të garantoj mundësitë e shkurorëzimit nga një bashkëshort i dhunshëm, dhe mbajtjen financiare dhe ushqimin adekuat për gratë dhe fëmijët, duke përfshirë bashkësitë jashtëmartesore. Po ashtu, duhet të garantohet e drejta e viktimës për të qëndruar në një banesë të përbashkët pas shkurorëzimit; e drejta në pronë si dhe e drejta në sigurimet sociale dhe pensionale. Njëkohësisht, kërkohet shqyrtimi i kujdesshëm i kujdestarisë së fëmijëve dhe vizitave në mënyrë që të përcaktohet nëse ka histori të dhunës, duke pranuar se mbrojtja e fëmijëve shpesh arrihet më së miri duke mbrojtur nënat e tyre. Mbrojtja nga dhuna në familje dhe e drejta për një jetë të lirë nga dhuna duhet të jetë një parim jo vetëm në legjislacionin kundër dhunës ndaj grave, por edhe në të gjitha fushat përkatëse të ligjit familjar.
- Legjislacioni duhet të njeh statusin e pavarur dhe të favorshëm të imigracionit për të mbijetuarat e dhunës ndaj grave. Legjislacioni duhet të njeh dhunën me bazë gjinore ndaj grave si një formë persekutimi, i cili do të merret parasysh kur vendoset sipas kërkesës për azil. Të mbijetuarave të dhunës duhen t'u mundësohet të aplikojnë në mënyrë të pavarur nga kryerësi i dhunës për imigracionin e ligjshëm. Për më tepër, legjislacioni duhet të respektoj parimin e moskthimit, për të siguruar që viktimat e dhunës ndaj grave nuk do të kthehen në asnjë vend ku jeta e tyre do të ishte në rrezik ose ku ato mund t'i nënshtrohen torturës, apo trajtimit çnjerëzor ose degradues. Të mbijetuarat e dhunës ndaj grave duhet të përbëjnë një grup të veçantë shoqëror për qëllimet e ligjit të azilit.

5.1 Lista e Kontrollit

Gjatë hartimit të legjislacionit mbi dhunën ndaj grave disa veprime duhet të konsiderohen dhe të ndërmerren në menyrë të standardizuar. Në vijim paraqitet një listë e kontrollit të hapave që duhet të merren gjatë hartimit të legjislacionit mbi dhunën ndaj grave.

Hapi 1:

Përcaktimi i qëllimit legjislativ

Në fillim të çdo procesi legjislativ, duhet të përcaktohet qartë qëllimi i legjislacionit. Qëllimi i legjislacionit kundër dhunës ndaj grave duhet të jetë parandalimi i dhunës ndaj grave, sigurimi i hetimit, ndjekjes dhe dënimit të kryerësve të veprave penale, dhe ofrimi i mbrojtjes dhe mbështetjes për viktimat/të mbijetuarit e dhunës, si dhe riedukimi i kryerësve të dhunës, që të përdorin një sjellje jo të dhunshme në marrëdhëniet ndërpersonale.

Hapi 2:

Konsultimi me palët e interesuara

Konsultimi gjithëpërfshirës me të gjithë aktorët që janë ose të prekur nga legjislacioni, ose që do të zbatojnë legjislacionin, është elementi kyç gjatë procesit përgatitor. Konsultimi siguron që përvojat dhe realitetet e grave që kanë përjetuar dhunën janë portretizuar me saktësi, dhe se përgjigjja legjislative është e përshtatshme, multi-disiplinare dhe gjithëpërfshirëse. Konsultimi gjithashtu rrit mundësinë që legjislacioni të zbatohet në mënyrë efektive.

Lista e mëposhtme jo-definitive e palëve të interesuara ofron një udhëzues se kush duhet të konsultohet në zhvillimin e legjislacionit mbi dhunën ndaj grave:

- Të mbijetuarit/viktimat;
- Organizatat joqeveritare që punojnë kundër dhunës ndaj grave, duke përfshirë edhe ato me përvojë në luftimin e dhunës ndaj grupeve të veçanta të grave, si pakicat etnike apo gratë me aftësi të kufizuara, ose gratë emigrante;
- Ofruesit e shërbimeve për të mbijetuarit/viktimat;
- Departamentet qeveritare, duke përfshirë të gjithë mekanizmat kombëtarë që punojnë në luftimin e dhunës ndaj grave dhe në fushën e fuqizimit të grave;

- Institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut;
- Policia dhe organet për zbatimin e ligjit;
- Prokurorët;
- Gjyqtarët;
- Juristët/shoqatat e avokatëve;
- Mbrojtësit e viktimave;
- Punëtorët e shëndetësisë;
- Stafi i Forenzikës;
- Punëtorët social/ofruesit e këshillimeve;
- Punëtorët në sistemin e arsimit;
- Zyrtarët e statistikave;
- Zyrtarët e burgjeve;
- Udhëheqësit fetarë;
- Liderët e komunitetit;
- Stafi i mediave.

Hapi 3:

Miratimi i qasjes së bazuar në fakte gjatë hartimit të legjislacionit

Qasja e bazuar në fakte dhe dëshmi siguron zhvillimin dhe hartimin e legjislacionit i cili i përshtatët realitetit të situatës së dhunës ndaj grave dhe i cili u përgjigjet nevojave për të parandaluar, luftuar dhe trajtuar dhunën ndaj grave. Legjislacioni i cili është mirë i informuar përmirëson cilësinë dhe efektivitetin e ardhshëm gjatë zbatimit të legjislacionit. Legjislacioni duhet të përgatitet bazuar në prova të besueshme duke përfshirë të dhënat dhe hulumtimet mbi vëllimin, prevalencën dhe incidencën e të gjitha formave të dhunës ndaj grave. Një rëndësi të posaçme kanë hulumtimet mbi shkaqet dhe pasojat e dhunës ndaj grave, si dhe përvojat dhe mësimet e mësuara gjatë adresimit dhe trajtimit të dhunës. Përvojat dhe praktikat e mira nga vendet tjera në parandalimin dhe adresimin e dhunës ndaj grave gjithashtu duhen të konsiderohen, duke i përshtatur ato kontekstit vendor.

6. Shtojca: Lista e kontakteve

Policia e Kosovës

Adresa: Rruga: "Luan Haradinaj" p.n. 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Kontakti nga telefonia fikse dhe mobile: 192 ose 038 550 999

Të gjitha thirrjet në numrin **0800 19 999** janë anonime, pa pagesë dhe konfidenciale.

Numrat e Stacioneve Policore

Rajoni i Prishtinës

Stacioni	Numri i Tel.	Numri fix/mobil pa pagese
Drejtoria Regjionale Prishtinë	038540021, 038249933, 038504504-2015	192
Trafiku Rajonal Prishtinë	038534234	
Stacioni Policor Obiliq	038561600	192 - Prishtinë
Stacioni Policor Fushë Kosova	038535812	192 - Prishtinë
Stacioni Policor Graçanica	038564292	192 - Prishtinë
Stacioni Policor Lipjan	038581010	192 - Prishtinë
Stacioni Policor Drenas	038/584092	192 - Prishtinë
Stacioni Policor Podujevë	038571805	192 - Prishtinë
Stacioni Policor Veriu	038249942	
Stacioni Policor Jugu	038549924	
Stacioni Policor Qendra	038502223	
N/Stacioni Policor Orllan	038614972, 038504504-7896	192 - Prishtinë
N/Stacioni Policor Bernicë	038515092, 038504504-7871	192 - Prishtinë
N/Stacioni Policor Magure	038502472	192 - Prishtinë
Nenstacioni Policor Janjevë	038567009	192 - Prishtinë

Rajoni Peja dhe Gjakova

Stacioni	Numri i Tel.	Numri fix/mobil pa pagese
Drejtoria Regjionale Pejë	039 432327 ; 038 504504-5000	192 - Pejë
Drejtoria Regjionale Gjakovë	038 504504-5510	192 - Gjakovë
Stacioni Policor Pejë	039 433273	192 - Pejë
Trafiku Rajonal Gjakovë	0390 323784	
Trafiku Rajonal Pejë	039 432595	
Stacioni Policor Gjakovë	0390 322482 ; 038 504504-5500	192 - Gjakovë
Stacioni Policor Istog	039 451374	192 - Pejë
Stacioni Policor Klinë	039 471199	192 - Pejë
Stacioni Policor Deçan	0390 361020	192 - Pejë
Stacioni Policor Rahovec	029 277913	192 -Gjakovë
Stacioni Policor Malishevë	038 269007	192 - Gjakovë
Nën Stacioni Policor Gorazhdevc	039 467389 ; 038 504504-5775	192 - Pejë
Nën Stacioni Policor Junik	0390 370092	192 - Gjakovë
Nën Stacioni Policor Vitomiricë	039/442 203, 038/504 504-5770	192 - Pejë
Nën Stacioni Policor Ponashevc	0390 370888	192 - Gjakovë

Rajoni i Mitrovicës

tacioni	Numri i Tel.	Numri fix/mobil pa pagese
Drejtoria Regjionale Mitrovicë	028/532 366, 038/504504-4000	192 - Mitrovicë
Njesia e Trafikut Rajonal Mitrovicë	028 532 628	
Stacioni Policor Mitrovicë Jugu	028 532 585	192 - Mitrovicë
Stacioni Policor Skenderaj	028/582 087	192 - Skënderaj
Stacioni Policor Vushtrri	028/572 010	192 - Vushtrri
Stacioni Policor ZubinPotok	028 461 042	192-Fiks,028/192-Mobil - Mitrovicë Veri
Stacioni Policor Zveqan	028 665 130	192-Fiks,028/192-Mobil - Mitrovicë Veri

Stacioni Policor/Regjioni Mitrovicë Veri	028 425 170, 038 504504-4215 & 038 504504-4200	192-Fiks, 028/192-Mobil - Mitrovicë Veri
Stacioni Policor Leposaviq	028/83 424	192-Fiks, 028/192-Mobil - Mitrovicë Veri
Nën Stacioni Policor Prilluzhe	028 573 509 , 038 5080-4542	192 - Vushtrri

Rajoni i Prizrenit

Stacioni	Numri i Tel.	Numri fix/mobil pa pagese
Drejtoria Regjionale Prizren	029/244 355 ose 038/504504-6000	192 - Prizren
Trafiku Regjional Prizren	029/244 655	
Stacioni Policor Suharekë	029/271 024	192 - Prizren
Stacioni Policor Dragash	029/281 017	192 - Prizren
Nënstacioni Policor Sredskë	038/502 575	192 - Prizren
Nënstacioni Policor Mushtisht	029/275 105	192 - Prizren
Nënstacioni Policor Mamushë	029/273 453	192 - Prizren
Nënstacioni Policor Zhur	029/625 092	192 - Prizren

Rajoni i Gjilanit

Stacioni	Numri i Tel.	Numri fix/mobil pa pagese
Drejtoria Regjionale Gjilan	0280/330 188 ose 038/504504-7001	192 - Gjilan
Stacioni Policor Gjilan	0280/330 061	192 - Gjilan
Trafiku Regjional Gjilan	0280/330 091	
Stacioni Policor Novoberda	038/576 092	192 - Gjilan
Stacioni Policor Viti	0280/381 513	192 - Gjilan
Stacioni Policor Kamenica	0280/372 390	192 - Gjilan
Nënstacioni Policor Kllokot	0280/381 094 , 038 504504-7886	192 - Gjilan
Nënstacioni Policor Ranillug	038/504504-7878	192 - Gjilan
Nënstacioni Policor Zheger	0280/386 011 , 038 5080-7508	192 - Gjilan
Nënstacioni Policor Pozharan	0280/386-269 ose 038 5080-7553	192 - Gjilan

Rajoni i Ferizajit

Stacioni	Numri i Tel.	Numri fix/mobil pa pagese
Drejtoria Regjionale Ferizaj	0290/322 406 ose 038/504504-3036	192 - Ferizaj
Stacioni Policor Ferizaj	0290/ 327 412	192 - Ferizaj
Trafiku Regjional Ferizaj	0290/321 899	
Stacioni Policor Shtërpçë	0290/70092, 038/541 271, 038/504504-3400	192 - Ferizaj
Stacioni Policor Kaçanik	0290/380 834	192 - Ferizaj
Stacioni Policor Hani i Elezit	0290/385 015	192 - Ferizaj
Stacioni Policor Shtime	0290/389 008	192 - Ferizaj

Zyra për Mbrojtjen dhe Ndhimën e Viktimave

1. Zyra e Regjionit të Prishtinës

Tel kujdestar : **044 278 738**

Telefoni fiks zyrtar: 038246-059- 038 200 18 738 (Centrex)

Adresa Pallati i Drejtësisë , Ndërtesa e Prokurorisë Themelore Objekti C , kati përdhese , Zyra nr C007 dhe COO6, Hajvali

Kontakti:

Basri Kastrati, **Menaxher i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave**

2. Zyra e Regjionit të Gjilanit

Tel kujdestar: **044 711 220**

Telefoni fiks zyrtar : 0280 320 462

Adresa : Ndërtesa Objekti i Prokurorisë Themelore Gjilan, Rruga Marije Shllaku pa numër, Gjilan

3. Zyra e Regjionit të Ferizaj

Telefoni kujdestar : **044 161 138**

Telefoni fiks zyrtar: 0290 325 602

Adresa Objekti i Prokurorisë Themelore në Ferizaj, Rruga e Reçakut, Ferizaj

4. Zyra e Regjionit të Prizrenit

Telefoni kujdestar: **044 310 468**

Telefoni fiks zyrtar 029-241-898

Adresa Ndërtesa e Prokurorisë Themelore në Prizren kati përdhese, Zyrat numër 01,02 dhe 04, Rruga William Walker, Prizren

5. Zyra e Regjionit të Pejës

Telefoni kujdestar **044 348 164**

Telefoni fiks : 039 421 194

Adresa Ndërtesa e Prokurorisë Themelore në Pejë, Kati i tretë, Zyra numër 28, Rruga Lekë Dukagjini, Pejë

6. Zyra e regjionit të Gjakovës

Telefoni kujdestar : **044 310 466**

Telefoni fiks: 0390 320 228

Adresa: Ndërtesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Kati përdhese, Rruga Nëna Terezë pa numër, Gjakovë

7. Zyra e regjionit të Mitrovicës

Telefoni kujdestar **044 310 468**

Telefoni fiks 028 543 489

Adresa Ndërtesa Stacioni Policor Jugu, kati i tretë, Rruga Bislim Bajgora, pn ,
Mitrovicë

Zyra e Linjës Ndhmëse– është numër telefonik publik dhe pa pagese në **kuadër të ZMNV-së** për t’ua mundësuar viktimave dhe publikut një mekanizëm konfidencial për raportimin e veprave të ndryshme penale të abuzimit: për informimin e viktimave dhe personave tjerë lidhur me të drejtat e tyre, sigurimin e informatave të nevojshme për shërbime ekzistuese dhe numrat kontaktues. Operatorët janë të angazhuar 24/7.

- Linja Ndhmëse është krejtësisht falas e hapur 24/7
- Çdo viktimë e k mund te thërras në këtë numër
- Thirrjet janë konfidenciale
- Kjo linjë ofron mbështetje dhe këshilla për të gjitha viktimat e krimit

Numri i Linjës Ndhmëse, falas 24 orë: 08001112

Agjencia për ndihmë juridike falas

Rr. Rrustem Hyseni, Prishtinë
Telefoni +381 38 200 189 42
E-mail;info-anjf@rks-gov.net

Zyrat për ndihmë juridike në Kosovë

Zyra për ndihmë juridike – Prishtinë

Rr. Rrustem Hyseni Nr. 30
tel:+381(0)38 200/18-945

Zyra për ndihmë juridike - Prizren

Rr. “Marin Barleti”, ish objekti I Kadastrit
tel:+381(0)29/230554

Zyra për ndihmë juridike - Pejë

Rr. „Bukuroshes” Nr. 8
tel:+381(0)39/ 423-698

Zyra për ndihmë juridike - Mitrovicë

Rr.”Vëllezërit Dragaj”, Nr. 16
tel:+381(0)28/534-477

Zyra për ndihmë juridike - Gjilan

Rr. “Mulla Idrizi”Nr. 41
tel:+381(0)280/321-134

Strehimore për mbrojtjen e viktimave

Qendra e Gruas në Prishtinë Tel. mob: +377/ 044/508-081

Shtëpia e sigurt në Gjakovë Tel +381/0390-30-098

Strehimorja ”Liria” në Gjilan Tel. mob: +377/ 044/125-729

Strehimorja në Mitrovicë Tel. mob: +377/ 044/158-686

Strehimorja në Prizren Tel. mob: +377/ 044/380-4

Qendrat për punë sociale

1. **Pejë** 039-433-473
2. **Deçan** 0390-361-014
3. **Junik** 044-253 293
4. **Klinë** 039-471-476
5. **Istog** 039-451-140
6. **Gjakovë** 0390-323-510
7. **Prishtinë** 038-244-841, 038-212- 478, 038-213 082
8. **Obiliq** 038-562-077
9. **Graçanicë** 049-776 700
10. **F.Kosovë** 038-536-462
11. **Gllgovc** 038-584-356
12. **Lipjan** 038-581-454
13. **Podujevë** 038-571-838
14. **Shtime** 0290-389-031
15. **Gjilan** 0280-320-140
16. **Novobërdë** 038-576-037
17. **Kllokot** 044-732517
18. **Partesh** 045-597496
19. **Viti** 0280-381-660
20. **Kamenicë** 0280-371-099
21. **Ferizaj** 0290-327-525
22. **Ranillug** 0280/75195
23. **Shterpce** 064-383-1543, 045-526561
24. **Hani i Elezit** 044-206889
25. **Kaçanik** 0290-380-671
26. **Mitrovica - J** 028-535-440
27. **Mitrovica - V** 028-424-468
28. **Zveçan** 028-665-159
29. **Leposaviç** 028-83977
30. **Skenderaj** 028-582-247
31. **Vushtrri** 028-572-006

32. Zubin Potok 028-460-064

33. Prizren 029-223-451

34. Dragash 029-281-227

35. Malishevë 029-269-004

36. Rahovec 029-276-663

37. Suharekë 029-271-165

38. Mamushë 045-546654

Avokati i popullit (Ombudspersoni)

Zyra Qëndrore, Prishtinë

Rr. "MIGJENI", nr. 21

+381 (0) 38 223 782; +381 (0) 38 223 783

+381 (0) 38 223 784; +381 (0) 38 223 789

Thirrjet falas për palët:

0800 15555

Fax: +381 (0) 38 223 790

E-mail adresa: info@ombudspersonkosovo.or

Zyra regjionale në Graçanicë

Rrr. "Car Lazari" p.n.

+381 (0) 38 223 783

+377 (0) 44 367 719,

+381 (0) 64 37 11 137

Zyra regjionale në Prizren

Rr. "Remzi Ademi", pn

Telefoni:

+381 (0)29 222 138

Zyra regjionale në Gjilan

Rruga "Bulevardi i Pavarësisë"

(ish ndërtesa e gjykatës) p.n.

+381 (0)280 320 843

Zyra regjionale në Ferizaj

Ndërtesa e Komunës (përdhësë)

+381 (0)290 326 032

Zyra regjionale në Pejë

Rruga "Mbretëresha Teutë", Nr.59,

Ndërtesa e Komunës, Kati III, nr. 3

+381 (0)39 432 931

Zyra regjionale në Gjakovë

Rr. "Ismail Qemali"

(ish ndërtesa e Kadastrës)

+381 (0)390 327 698

Zyra regjionale në Mitrovicë

Rruga Rruga " Afrim Zhitia" n/n

(Ndërtesa e Administratës Pensionale të Kosovës),

Kati 3, Zyra No. 11 and 12.

+381 (0) 28 530 138

Nën zyra në Mitrovicë

Adresa: Rr. "Sami Frashëri", pn.Lagja e boshnjakëve,

Ndërtesa e ZAK në veri të Mitrovicës

+ 377 (0)45 455 319

+381 (0)64 956 00 50